

Prof. Dr. Sali Berisha
Ish President dhe ish Kryeministër i Republikës së Shqipërisë
E-mail: profsberisha@gmail.com

SI REFORMA NË DREJTËSI E ÇOI DREJTËSINË SHQIPTARE NËN KONTROLLIN E PARTISË SOCIALISTE DHE ROLI I XHORXH SOROS

Përmbledhje ekzekutive

Në korrik të 2021 mbushen pesë vite nga votimi në parlament i paketës kushtetuese të Reformës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, e cila i solli vendit një sistem drejtësie totalisht të kontrolluar nga ekzekutivi. Kjo reformë është ideuar, iniciuar, financuar, nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur (OSF) dhe është draftuar nga bashkëpunorët e këtij Fondacioni. Pas dështimit të saj dhe rënies dramatike të besimit të qytetarve tek reforma dhe sistemi i drejtësisë¹ eksponentë kryesorë të OSF, në Shqipëri dhe në Europë, përpiqen të mohojnë rolin prej promotori kryesor të OSF në këtë reformë².

Por dokumentet e vetë OSF dhe dokumente të tjera zyrtare provojnë se:

1. Ideja e Reformës të Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri u formulua pas ardhjes së Edi Ramës në pushtet nga OSF, në Planin e Strategjisë për vitet 2014-2017 të këtij Fondacioni, të publikuar në dhjetor të vitit 2013³.

2. OSF do të ishte jo vetëm ideator dhe iniciator i kësaj reforme, por dhe financues e promotori i saj⁴.

¹ [Sondazhi/ 63% nuk besojnë te Vettingu. Ç'lojë po luan Soros? – Lapsi.al](#) publikuar më 08 prill 2019, shkarkuar më 22 gusht 2021. [Për të tretin vit rradhazi, ulet besimi te Reforma në Drejtësi - Exit | Shpjegon Shqipërinë](#) datë 13 maj 2020, citon një tjetër sondazh të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim në lidhje me Besimin në Qeverisje 2019, publikuar në 2020, [Public Opinion Poll: Trust in Governance 2019 - \(idmalbania.org\)](#), Zëri i Amerikës, datë 22 mars 2021 (<https://www.zeriamerikes.com/a/5824060.html>) citon Barometrin e Sigurisë Shqipëri për 2020, studim në rang kombëtar i kryer nga CSDG dhe fondacioni Friedrich Ebert Stiftung, http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2021/03/barometri_i_sigurise_2020_SHQIP-WEB.pdf shkarkuar më 22 gusht 2021.

² Goran Buldioski; [Balkan Conspiracy Theories Come to Capitol Hill – Foreign Policy](#), March 2017, shkarkuar më 13 korrik 2021, <https://foreignpolicy.com/2017/03/28/soros-gop-letter-open-society-macedonia-albania/>

³ <https://www.scribd.com/document/326653998/Ja-Dokumenti-i-Strategjise-se-Fondacionit-Soros-Albania-2014-2017-ge-tregon-se-kush-po-e-ben-Reformen>, shkarkuar më 13 korrik 2021.

3. Në maj të vitit 2014 OSF organizoi një seri tryezash të gjera të debateve, me perfaqësues të grupeve të interesit për aspektet themelore të kësaj reforme⁵.

4. Pas kësaj OSF me qeverinë krijoi trurin e reformës - Grupin e Ekspertëve të Lartë të Reformës në Drejtësi (GELR), i cili përbëhej nga bashkëpunorë të OSF, ish ministra, zëvendës ministra e zyrtarë të tjerë të Partisë Socialiste, si dhe ekspertë të misioneve për ligjin pranë ambasadave të SHBA dhe BE⁶. Antarët e GELR në përputhje me parimin kush paguan vendos, u paguan nga OSF deri në fund të reformës⁷. GELR nuk pranoi si antar asnjë nga kandidaturat e propozuara nga opozita.

5. Misioni i GELR, si truri i reformës, ishte hartimi i amandamenteve kushtetuese dhe ligjeve organike të reformës së drejtësisë, të cilat miratoheshin në Komisionin e Posaçëm Parlamentar të Reformës (KPPR) vetëm me votat e mazhorancës. Opozita ndonëse pa të drejtë vetoje dhe anipse ekspertët e saj nuk u pranuan nga GELR, mori pjesë në KPPR. Ajo vuri si kusht të vetëm për këtë pjesmarrje dërgimin në Komisionin e Venecias për opinion të draftit të ndryshimeve kushtetuese të përgatitur nga GELR dhe të miratuar nga KPPR vetëm me votat e mazhorancës, si edhe oponencën e opozitës ndaj këtij drafti. Palët binin dakord të pranonin rekomandimet e Komisionit të Venecias.

6. OSF mori përsipër zhvillimin e sondazheve të opinionëve për drejtësinë dhe reformën e saj. Rezultatet e tyre dallonin shumë me sondazhe të tjera serioze ndërkombëtare. Me këto sondazhe ajo orientonte punën e GELR dhe propagandën e promovimit të reformës.

7. Pas filimit të punës për reformën doli qartë se GELR:

a) paraqiti një model të sistemit drejtësisë *sui generis*, që nuk ekziston në asnjë vend të botës dhe,

b) me modelin e tij, GELR kishte si qëllim kryesor të reformës vendosjen e sistemit të drejtësisë nën kontrollin e qeverisë.

8. Dy draftet e reformës në drejtësi të hartuara gjatë vitit 2015 iu dërguan Komisionit të Venecias, sipas kërkesës këmbëngulëse të opozitës, së bashku me komentet (observacione) e kësaj të fundit. Komisioni Venecias rrëzoi njëri pas tjetrit në dhjetor të

⁴ Për burimet shih footnotes 19-24.

⁵ Top Channel TV, Vendi përballë ndryshimit të kushtetutës, 26 Maj 2014, shkarkuar më 18 korrik 2021 <https://top-channel.tv/video/vendi-perballe-ndryshimit-te-kushtetutes/>

⁶ Për cv-të e Grupit të Ekspertëve të Lartë të Reformës në Drejtësi shih *Reforma ne sistemin e drejtësisë. Analiza dhe strategjia*. Vëllimi I, Pjesa e Pare, faqe 147 et seq, botim I Parlaamentit shqiptar, 2017, ISBN 978-9928-166-75-3, <https://www.parlament.al/Files/Informacione/V%C3%ABllimi%20i%20par%C3%AB,%20pjesa%20e%20par%C3%AB.pdf> shkarkuar më 20 korrik 2021.

⁷ *Reforma ne sistemin e drejtësisë. Analiza dhe strategjia*. Ibid., faqe 18, shih gjithashtu dhe <https://www.pressreader.com/albania/gazeta-shqiptare/20191005/281625307046673>

vitit 2015 dhe mars të vitit 2016 dy draftet e ndryshimeve kushtetuese të përgatitura nga GELR sepse ato e vendosnin drejtësinë nën kontrollin e ekzekutivit⁸. Ndërkohë komentet e opozitës për këto drafte përputheshin me rekomandimet e Komisionit të Venecias.

9. Pas rrëzimit të këtyre dy drafteve të GELR dhe KPPR nga Komisioni i Venecias, me insistimin e opozitës dhe ndërmjetësimin e zyrtarëve të lartë ndërkombëtarë, u arrit që nga drafti i ndryshimeve kushtetuese të hiqen mekanizmat ligjore të kapjes së sistemit të drejtësisë, dhe me 21 Korrik 2016 të votohet në parlament me unanimitet paketa e ndryshimeve kushtetuese të reformës, e cila përputhej me rekomandimet e Komisionit të Venecias. Për rolin në mbrojtjen e parimeve demokratike të drejtësisë, opozita mori përgëzime nga zyrtarë të niveleve më të larta ndërkombëtare, ndonëse propaganda e OSF dhe qeverisë për të mbuluar dështimet e tyre e paraqisnin atë si forcë antireforme.

10. Por pas kalimit të paketës kushtetuese, qeveria dhe GELR rikthyen në ligjet organike të reformës të gjitha filtrat e përzgjedhjes së kandidaturave, si mekanizma të kapjes së drejtësisë, që ishin hedhur poshtë më parë nga opozita dhe Komisioni i Venecias. Qeveria miratoi këto ligje bazuar vetëm me votat e saj duke shkelur marrëveshjen me opozitën për votimin e tyre me konsensus.

11. Bazuar në këto ndryshime ligjore dhe për realizimin e kapjes së drejtësisë, qeveria emëroi në krye të filtrarve që do të përzgjidhnin kandidaturat për organet drejtuese të sistemit të drejtësisë nga shoqëria civile, universitetet dhe avokatia, më të besuarit e saj si S. Sadushi, A. Dvorani, M. Haxhia, të tre antarë të GELR dhe bashkëpunëtorë të OSF.

12. Nga këto filtra duke aplikuar standarte të dyfishta u përzgjedhën si kandidatura për në krye të organeve kushtetuese të drejtësisë, individë që kishin besimin politik të mazhorancës, por që nuk plotësonin kushtet minimale kushtetuese dhe ligjore për ushtrimin e këtyre funksioneve, gjë për të cilën kandidatë të tjerë u skualifikuan.

13. Nga kandidaturat e përzgjedhura u emëruan nga parlamenti në krye të organeve drejtuese të sistemit të drejtësisë, në kundërshtim të hapur me kriteret kushtetuese dhe ligjore, ish gjykatës dhe prokurorë të proceseve politike gjatë diktaturës komuniste, ish ministra, zëvendës ministra, vëllezër, kunetër të ministrave të PS, bashkëpunorë ose ish-punonjës të OSF, si A. Metani, G. Ibrahim, I. Panda, S. Sadushi, A. Dvorani e të tjerë⁹.

⁸ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), Interim Opinion On The Draft Constitutional Amendments On The Judiciary Of Albania, Opinion No. 824 / 2015, datë 21.12.2015, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2015\)045-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2015)045-e) shkarkuar më 20 korrik 2021.

European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), Final Opinion On The Revised Draft Constitutional Amendments On The Judiciary Of Albania, Opinion No. 824 / 2015, i 15 janar 2016 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)009-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)009-e) shkarkuar më 20 korrik 2021.

⁹ Për detajet shih seksionin 2.2 të raportit.

14. Për kapjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), dhe të Gjykatës Kushtetuese (GJK), Edi Rama personalisht bllokoi për dy vite me radhë, i mbështetur në njërin vit edhe nga ambasadori i SHBA D. Lu, veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), i cili përzgjedh kandidaturat për organet e mësipërme duke lënë kështu vendin pa GJK dhe ILD¹⁰. Ata e bënë këtë me pretekstin se anëtarët e KED, të zgjedhur me short, nuk kishin bërë vetingun¹¹. Por shkaku i këtij bllokimi qëndronte në faktin se qeveria nuk kontrollonte dot KED e vitit 2017 dhe vitit 2018 me përbërjen e tyre të dalë nga shorti. Ndërkohë, Komisioni i Venecias konstaton se vetingu i antarëve të KED “nuk kërkohet nga kushtetuta dhe ligjet dhe puna e këtij organi nuk mund të bllokohej.”¹² Pas ardhjes së A. Dvoranit në vitin 2019 në krye të KED, pra me vënien në kontroll të këtij organi nga qeveria socialiste, qeveria nuk kërkoi më vetingun për antarët e KED.

15. Përveç këtyre, për kapjen e sistemit të drejtësisë qeveria përdori për gjah shtrigash dhe instrument pengmarrje procesin e domosdoshëm të vetingut të gjykatësve dhe prokurorëve. Nëpërmjet këtij procesi ajo largoi nga detyra, duke zbatuar standarte të dyfishta të gjithë gjykatësit dhe prokurorët që i konsideronte kundërshtarë të saj, duke u nisur nga çështjet që ata kishin gjykuar në lidhje me zyrtarët e qeverisë apo bosët e krimit të lidhur me qeverinë. Ndërkohë që mbajti në punë për të njëjtat shkelje ligjore, madje edhe më të rënda, ata që konsideroheshin besnikë të Partisë Socialiste. Për më tepër, ligji për vetting-un e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk shtrin efektet e tij tek kandidatët për gjyqtarë që vijnë jashtë sistemit të drejtësisë dhe vetting-u i tyre bëhet nga KLGJ dhe jo nga KPK apo KPA. Në vetvete përbën një unikalitet të pashoq fakti që kriteret e kontrollit të pasurisë së kandidatëve që vijnë nga jashtë sistemit gjyqësor të jenë shumë here më të lehta se ato që zbatohen për gjyqtarët që shërbejnë në sistem. Disa nga gjyqtarët që nuk u kontrolluan nga KPK por nga KLGJ janë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë si S.Sadushi, I Panda. Pupo. Rezultatet e veting-ut të tyre, të kryera nga KLGJ, në kundërshtim të hapur me kushtetutën, mbahen *top secret*, kjo padyshim edhe si një mekanizëm shantazhi ndaj tyre.

16. Po në funksion të kapjes së sistemit të drejtësisë, GELR dhe qeveria përzgjedhën për procesin e veting-ut metodën *top-down*, që do të thotë se procesi i vetting-ut duhet të fillojë me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë. Në fakt, vendimet e

¹⁰ Për detajet shih seksionin 2.3 të raportit.

¹¹ Ambasadori i SHBA në Shqipëri Donald Lu në konferencën “Pjesëmarrja qytetare dhe demokracia direkte”, <https://al.usembassy.gov/sq/fjala-e-ambasadorit-lu-ne-konferencen-pjesemarrja-qytetare-dhe-demokracia-e-drejtperdrejte/> shkarkuar më 30 gusht 2021

¹² European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), Albania Opinion On The Appointment Of Judges To The Constitutional Court, No. 978/2020, datë 19 qershor 2020 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2020\)010-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2020)010-e), §90-91, shkarkuar më 30 gusht 2021.

gjykatëse të gjykatave të qarkut në tërësinë e tyre nuk kanë pasojë politike dhe mund të korrigjohen në gjykatën e apelit. Metoda top-down konsiderohet destruktive pasi lejon ndërhyrje nga sipër dhe krijon vakum. Opozita e ka mbështetur si të domosdoshëm procesin e vettingut, por ajo ka denoncuar përdorimin e standarteve të dyfishta dhe ka insistuar për aplikimin e metodës *botom up* në procesin e vettingut, sepse ajo nuk lejon ndërhyrjen nga sipër dhe nuk do të krijonte vakum në sistemin gjyqësor¹³.

17. Si rezultat i përdorimit të metodës *top-down*, vakumit të krijuar prej saj por dhe përpjekjeve të hapura të qeverisë për të kapur me çdo kusht Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD), vendi mbeti thuajse për katër vite pa ILD, pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë të Lartë. Sot gjykatat e apelit kanë mbetur me një të katërtën e gjykatësve e po kështu dhe ato të faktit, Gjykata e Lartë me gjysmën e gjyqtarëve që duhet të ketë dhe Gjykata Kushtetuese nuk është plotësuar ende. Nga ky vakum, gjatë këtyre pesë viteve u krijuar një stok prej 100,000 dosjesh gjyqësore të pashqyrtuara nga gjykatat, nga të cilat mbi 30,000 janë të Gjykatës së Lartë, e cila edhe sot ka vetëm nëntë antarë, nga nëntëmbëdhjetë që duhet të ketë. Ekspertët mendojnë se për shqyrtimin e dosjeve të këtij stoku do të duhen rreth dy dekada. Pesë vite pas miratimit të parlamentit për reformën gjyqësore, nga 830 gjyqtarë e prokurorë që ka sistemi vetëm 420 i janë nënshtruar procesit të vetting-ut, nga të cilët rreth 200 nuk kanë arritur t'a kalojnë atë dhe kanë dalë nga sistemi i drejtësisë.

18. Si *colpo di gracia* i kapjes së drejtësisë ishte vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor për t'i dhënë me koncesion administrimin e dosjeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Institutit East-West Management Institute (EWMI), me një marrëveshje antiligjore dhe antikushtetuese. Në Shqipëri EWMI drejtohet nga Delina Fico, bashkëshortja e ministrit të brendshëm B. Çuçi dhe ish bashkëshortja e Edi Ramës, e cila është dhe një ish drejtuese e OSF. Ekspertët e këtij institutit janë antarë të Klubit të Juristëve të Rinisë Socialiste dhe nuk plotësojnë kushtet minimale që përcakton ligji për këshilltarët ligjorë të Gjykatës së Lartë, të cilët duhet të jenë magjistratë ose të kenë vjetërsi pune dhe kualifikime profesionale të mirë-përcaktuara. Në bazë të nenit 179/2 § 4 të Kushtetutës ata duhet t'i nënshtrohen të njëjtit process vetting-u si dhe gjykatësit. Asnjë nga personat e EWMI që do të administrojnë dosjet e Gjykatës së Lartë nuk i është nënshtruar vetting-ut. Ndaj kjo marrëveshje është jo vetëm në shkelje të nenit 179/2 § 4 të Kushtetutës, por cënon gjithashtu një nga të drejtat themelore të njeriut – të drejtën për t'u gjykuar nga gjë gjykatë e krijuar me ligj, siç parashikohet në nenin 6 § 1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut¹⁴.

¹³ Qeveria refuzoi me force kalimin e një projekt ligji të dërguar në parlament nga opozita, i cili parashikonte shtrirjen e procesit të vetting-ut tek politikanët.

¹⁴ Për detajet shih seksionin 2.7 të raportit..

19. Sot mbi 90 përqind të proceseve gjyqësore i fiton qeveria, bandat dhe kartelet e drogës të lidhura me të. Para vitit 2013, 65-70 përqind të proceseve gjyqësore kundër qeverisë i fitonin qytetarët dhe bizneset. Nga shtatori 2005 gjer në dhjetor 2006, Prokuroria e Krimeve të Rënda, task-force antikorrupsion pranë prokurorisë dhe Gjykata e Krimeve të rënda vendosën para ligjit dhe dënuan mbi 1050 antarë dhe bosë të grupeve kriminale, si dhe qindra zyrtarë, përfshi edhe zyrtarë të lartë për korrupsion. Kjo bëri të mundur antarësimin e Shqipërisë në NATO, firmosjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, liberalizimin e vizave me hapësirën e Shengen, marrjen e rekomandimit të Komisionit European për statusin e vendit kandidat, katërfishimin e investimeve të huaja, dhe kalimin e vendit nga grupi i vendeve të varfëra në grupin e vendeve me të ardhura të mesme të larta.

20. Gjatë këtyre 5 viteve, në tërësi bosët e bandave të mëdha jo vetëm janë të paprekur, por janë liruar njëri pas tjetrit vetëm për shkak të lidhjeve të tyre me pushtetarët disa nga bosët mafiozë e vrasës serialë të dënuar me burgime të përjetshme para vitit 2013. Shqipëria është bërë prodhuesi kryesor i kanabisit në Europë, rruga kryesore e kalimit të heroinës në kontinent dhe një epiqendër e kokainës nga Amerika e Jugut. Shqipëria konsiderohet narko-shteti i parë dhe unik i Europës¹⁵. Lufta kundër korrupsionit në tërësi është e kufizuar tek zyrtarë të niveleve jo të larta dhe në afëra të vogla. Kurse dosjet e aferave të mëdha të zyrtarëve të lartë nuk preken. Këtë vit Shqipëria, sipas Bankës Botrore, renditet e dyta në botë për nivelin e ryshfetit¹⁶. Kapja e shtetit ka arritur në format më të avancuara në rajon¹⁷. Asnjë investitor serioz i huaj nuk

¹⁵ 'Colombia of Europe': How tiny Albania became the continent's drug trafficking headquarters, The Independent, 27 janar 2019, <https://www.independent.co.uk/news/world/europe/albania-drug-cannabis-trafficking-hub-europe-adriatic-sea-a8747036.html> shkarkuar më 22 gusht 2021.

The Inside Story of Europe's First Narco-State, [The Inside Story of Europe's First Narco-State \(vice.com\)](https://www.vice.com/en/article/the-inside-story-of-europes-first-narco-state) 6 qershor 2019, shkarkuar më 25 gusht 2021.

The Proliferation of Organized Crime Groups in Europe's First "Narco-State": A Look at Albania in the post-Cold War Era, Diana Roy, The World Mind Issue, 5.2,

<https://www.theworldmind.org/home/category/World+Mind+Issue+5.2> shkarkuar më 22 gusht 2021.

'I Might Buy it All': Albania Fights Losing Battle against Money Laundering, BIRN, Klodiana Lala, 10 mars 2021, <https://balkaninsight.com/2021/03/10/i-might-buy-it-all-albania-fights-losing-battle-against-money-laundering/> shkarkuar më 22 gusht 2021.

¹⁶ <https://www.enterprisesurveys.org/en/data/exploreconomies/2019/ai>

¹⁷ Raporti rajonal: Në Shqipëri shfaqet forma më e rëndë e kapjes së shtetit, grupet përdorin entet publike "për të luftuar" njëri-tjetrin, Revista Monitor, datë 9.05.2021, <https://www.monitor.al/raporti-rajonal-ne-shqiperi-shfaqet-forma-me-e-rende-e-kapjes-se-shtetit-grupet-perdorin-entet-publike-per-te-luftuar-njeri-tjetrin> shkarkuar më 22 gusht 2021.

Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri: Një shqyrtim i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe ligjeve të bëra me porosi nga viti 2008 deri në 2020, raport nga Transparency International dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2021, ISBN: 978-3-96076-171-6,

https://images.transparencycdn.org/images/2021_Report_DeconstructingStateCaptureAlbania_Albanian.pdf

shkarkuar më 22 gusht 2021. Për një përmbledhje të tij shih Raporti për kapjen e shtetit/ 9 ligjet që u votuan për

ka ardhur në Shqipëri, ndërkohë që janë larguar disa prej tyre nga vendi. Mungesa për rreth 4 vite e Gjykatës të Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese u bë njëri nga shkaqet më kryesore për moshapjen e negociatave të Shqipërisë me BE.

21. Si përfundim: reforma e drejtësisë në Shqipëri, me ideator, iniciues, sponsor dhe promotor kryesor OSF, shkatërroi sistemin e brishtë ekzistues të drejtësisë në vend dhe e zëvendësoi atë me një sistem drejtësie *sui generis*, totalisht të kapur nga qeveria socialiste, duke i shkatërruar kështu shtyllën vertebrore shtetit ligjor në Shqipëri. Kjo reformë privoi këto pesë vite dhe, për shkak të stokut të dosjeve, do të privojë për dekada qytetarët shqiptarë nga një proces gjyqësor i drejtë. Mijëra e mijëra qytetarë të moshuar nuk do mund të marrin për së gjalli një vendim nga gjykatat e vendit.

OSF me veprimtarinë e tij partizane i ka bërë një dëm të pallogaritshëm demokracisë së brishtë në Shqipëri. Së pari, me vendosjen e rrjetit të OJQ nën ombrellën e Partisë Socialiste (PS), OSF riktheu modelin monist të tyre në Shqipëri dhe sot ato nuk janë më zëra të pavarur të shoqërisë por organizata të manipuluar nga kjo parti. Së dyti, me vendosjen e drejtësisë nën kontrollin e personave që I takojnë ose kanë lidhje të ngushta me qeverinë ish-komuniste, OSF ka kontribuar *de facto* në zëvendësimin e shtetit të së drejtës me udhëheqjen e partisë-shtet, e cila sot kontrollon 90% të të gjithë pushteteve në Shqipëri¹⁸.

Për sa më sipër është urgjente që Kongresi i SHBA, Parlamenti Europian dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës të ndalojnë me ligj ndërrjetet politike partizane të multimiliardierit George Soros jashtë teritorit të SHBA, ose më së paku në vendet ish-komuniste.

Gjithashtu, janë shumë të ngutshme zbatimi i rekomandimit të Venecias për përshpejtimin ose amendimin e procesit të vetting-ut si dhe ndërhyrjet e tjera ligjore, me asistencën e Komisionit të Venecias, që synojnë:

- Trajtimin e stokut të dosjeve të krijuar në gjykata, mbi një procedure të bazuar në ligj, si dhe
- Nxjerrjen e sistemit të drejtësisë jashtë kontrollit qeveritar

si aspekte vitale të shtetit të së drejtës dhe demokracisë në Shqipëri.

interesa okulte, Lapsi.al, datë 30.03.2021, <https://lapsi.al/2021/03/30/raporti-per-kapjen-e-shtetit-9-ligjet-qe-u-votuan-per-interesa-okulte/> shkarkuar më 22 gusht 2021.

¹⁸ Sipas një studimi të institutit të Studimeve Politike, <https://politiko.al/isp-ps-dreiton-90-te-te-gjithe-pushtetit-politik-ne-vend-me-shume-se-partia-e-punes-ne-91-shin> shkarkuar më 30 gusht 2021.

1. Roli i Fondacionit të Shoqërisë së Hapur të Xhorxh Soros në vënien e drejtësisë shqiptare nën kontrollin e Partisë Socialiste të Shqipërisë nëpërmjet reformës në drejtësi.

Është i fakt i gjithëpranuar në Shqipëri, por edhe jashtë saj, se George Soros ka arritur të kontrollojë thuajse tërësisht OJQ-të shqiptare, duke i financuar ato nëpërmjet Fondacionit të Shoqërisë së Hapur në Tiranë, OSFA, dhe duke diktuar nëpërmjet këtyre financimeve nxjerrjen jashtë tregut të çdo aktori tjetër që përpiqet të ketë një zë të ndryshëm nga ai i network-ut të sponsorizuar nga OSF. Dëmi që pëson një vend nga mungesa e diversitetit, apo thuajse monizmi i shoqërisë civile, është i pallogaritshëm. Ai është edhe më i madh në një shoqëri që vjen nga e kaluara jo e largët e një monizmi absolut. OJQ-të në Shqipëri sot janë thuajse tërësisht në funksion të Partisë Socialiste të Shqipërisë (PS) dhe të majtës në tërësi, duke zbehur kështu diversitetin, por edhe peshën e tyre në opinionin publik¹⁹.

Mbi të njëjtën filozofi OSF, pas vitit 2013, ndërmori një rol thelbësor në ristrukturimin e drejtësisë shqiptare, nëpërmjet të ashtuquajturës reformë në drejtësi, me qëllimin e vetëm vënien e sistemit të drejtësisë në shërbim të së majtës dhe më konkretisht të Partisë Socialiste, të drejtuar nga Edi Rama - një mik i ngushtë dhe protégée i George Sorosit²⁰. Ndër instrumentat kryesore që OSF përdori për këtë qëllim, ishte kapja e trurit të reformës, nëpërmjet emërimit të njerëzve të financuar e kontrolluar nga OSF dhe Partia Socialiste në Komisionin e Ekspertëve të Lartë, si dhe institucionet kryesore që dolën nga kjo reformë, si Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Komisioni i Pavarur i Apelitimit (KPA), Inspektoriat i Lartë i Drejtësisë (ILD), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), apo Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Thuajse në të gjitha rastet, këto emërimet u bënë në shkelje të kritereve kushtetuese apo ligjore që duhej të plotësonin kandidatët për këto funksione.

Pas një sërë dështimesh të qarta dhe të pamohueshme të reformës së drejtësisë në Shqipëri, sot ka një polemikë të gjerë brenda dhe jashtë vendit mbi rolin e George Sorosit dhe Fondacionit të Shoqërisë së Hapur, OSF, në Tiranë. Aktualisht drejtues të tij në Shqipëri dhe në Europë, pas dështimit të paralajmëruar të reformës, përpiqen fort të mohojnë pa asnjë bazë rolin e këtij fondacioni në këtë reformë²¹.

Partia Demokratike ka qenë e vendosur të merrte pjesë në procesin e reformës dhe të jepte kontribut për vendosjen e saj mbi parimet universale të balancës e kontrollit dhe

¹⁹ [SOROS në Shqipëri.Emrat e Politikaneve ne PS e PD .Nga Altin Goxhaj: – Leter kontenja \(wordpress.com\)](https://telegraf.al/politike/si-e-kontrollon-miliarderi-george-soros-okb-ne-permes-ojf-ve-te-tij/)
<https://telegraf.al/politike/si-e-kontrollon-miliarderi-george-soros-okb-ne-permes-ojf-ve-te-tij/> 01.08.2021,
shkarkuar më 10.10.2021.

²⁰ One of the most recent examples: “[Rama: Shqiptarët duhet të falenderojnë Sorosin - Exit | Shpjegon Shqipërinë](#),” 27.09.2021, shkarkuar më 10.10.2021.

²¹ Goran Buldioski; Balkan Conspiracy Theories Come to Capitol Hill – Foreign Policy, Mars 2017, shkarkuar në 13 korrik 2021, <https://foreignpolicy.com/2017/03/28/soros-gop-letter-open-society-macedonia-albania/>

shtetit të së drejtës. Por, siç demonstrojnë faktet dhe dokumentat e parashtruara më poshtë, OSF dhe PSSH bënë çdo gjë për kapjen e drejtësisë shqiptare dhe për pasojë shkatërruan çdo shpresë për reformimin e saj.

1.1 Pas zgjedhjeve të vitit 2013, për të mbështetur qeverinë e Edi Ramës, njeriut tek i cili George Soros ka investuar më shumë se te kushdo tjetër në rajon, dhe për të vendosur drejtësinë shqiptare nën kontrollin direkt të personave që kishin qenë pjesë ose kishin lidhje të ngushta me ish-qeveritë komuniste, njësoj siç kishte bërë me OJF-të, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur në Tiranë (OSF), u bë iniciator i paketës së ndryshimeve kushtetuese dhe organizator i tryezave të debatit mbi reformën në drejtësi. OSF hartoi në fund të vitit 2013 planin e strategjisë për vitet 2014-2017, i cili parashikonte ndryshime kushtetuese dhe ligjore në funksion të reformës në drejtësinë shqiptare dhe reformës zgjedhore²².

1.2 Po kështu, nga data 8 deri në 12 maj të vitit 2014 OSFA organizoi, drejtoi dhe financoi disa tryeza konsultative të gjera për aspekte të ndryshme të reformës në drejtësi²³.

1.3 Pas këtyre tryezave mazhoranca në bashkëpunim me OSF-në krijoi Komisionin e Posaçëm Parlamentar të Reformës në sistemin e drejtësisë (KPPR) dhe krahas tij u krijua Komisioni i Ekspertëve të Lartë të reformës në drejtësi (KEL), në të cilin, përveç ish-ministrave dhe zv/ministrave të Partisë Socialiste, si I. Panda dhe disa të tjerë, gjykatës dhe prokurorë të gjyqeve politike të diktaturës staliniste, A. Dvorani, S.Sadushi apo hartuesi i kushtetutës staliniste të vitit 1974, nipi i diktatorit Enver Hoxha, L. Omari, u përfshinë juristë të OSF në Shqipëri apo degë të tjera të saj, e drejtë që nuk u rezervua për asnjë fondacion apo grupim tjetër. Në tërësi, të gjithë ekspertët shqiptarë të këtij komisioni ishin njëkohësisht ish-punonjës dhe bashkëpunëtorë të OSF²⁴.

1.4 Komisioni i Ekspertëve të Lartë (KEL), si truri i reformës, kishte për detyrë hartimin e amendamenteve kushtetuese dhe ligjeve organike të reformës në sistemin e

²² <https://www.scribd.com/document/326653998/Ja-Dokumenti-i-Strategjise-se-Fondacionit-Soros-Albania-2014-2017-ge-tregon-se-kush-po-e-ben-Reformen> , shkarkuar më 13 korrik, 2021.

²³ Top Channel TV, Vendi përballë ndryshimit të kushtetutës, 26 May 2014, shkarkuar më 18 korrik 2021 <https://top-channel.tv/video/vendi-perballe-ndryshimit-te-kushtetutes/>

²⁴ Për cv-të e grupit të Ekspertëve të Lartë të Reformës në Drejtësi shih *Reforma ne sistemin e drejtësisë. Analiza dhe strategjia*. Vëllimi I, Pjesa e Pare, faqe 147 e në vazhdim, botim i Parlamentit Shqiptar, 2017, ISBN 978-9928-166-75-3, <https://www.parlament.al/Files/informacione/V%C3%ABllimi%20i%20par%C3%AB,%20pjesa%20e%20par%C3%AB.pdf> shkarkuar më 20 korrik 2021.

drejtësisë. Anëtarët e KEL, sipas parimit “kush paguan vendos”, do të paguheshin deri në fund të reformës direkt nga Fondacioni Soros²⁵.

1.5 Për të legjitimuar rolin e OSF në procesin e reformës, me kërkesën e këtij të fundit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar i kryesuar nga Fatmir Xhafa, një ish-prokuror i gjyqeve politike të diktaturës dhe deputet i PS, në datën 2 dhjetor 2014 me vendimin e tij No.5 vendosi: “1. T’i drejtohet Fondacionit Soros me një kërkesë për bashkëpunim, bazuar edhe në interesin e shprehur nga drejtuesit e këtij fondacioni, për të mbështetur veprimtarinë e komisionit dhe veçanërisht punën e grupit të ekspertëve dhe sekretariatit teknik; 2. Të përgatitet dhe të nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit midis Komisionit të Posaçëm dhe Fondacionit Soros, që do të përcaktojë në mënyrë të detajuar termat e referencës të këtij bashkëpunimi ”²⁶.

1.6 Në fillim të vitit 2015 OSFA fillon sondazhet e opinioneve në mbështetje të orientimit të punës së Komisionit të Ekspertëve të Lartë dhe drejttimeve që dëshiron të jepte reformës në drejtësi. Kështu, për shembull, ndër të tjera ky fondacion i drejton me e-mail një pyetësor stafit të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

1.7 Mbi rolin përcaktues të Fondacionit Soros në reformën në drejtësi vlen të përmendet edhe deklarata publike e kryetarit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, Fatmir Xhafa, në dhjetor të vitit 2015: ”Një falënderim mirënjohjeje dua t’i shpreh Fondacionit Soros, Andit (drejtori ekzekutiv) dhe ekipit të tij të palodhur për suportin e fortë teknik e financiar, përcaktues për ecurinë e mbarë të procesit dhe padyshim nismëtar për nevojën e një projekt ndryshimesh kushtetuese në vend”²⁷.

1.8 Qeveria Rama, duke mos patur votat për ndryshime kushtetuese, ftoi opozitën të marrë pjesë në Komisionin e Posaçëm Parlamentar të kësaj reforme, por refuzoi në mënyrë kategorike dhe në kundërshtim me praktikën e mëparshme, një marrëveshje me opozitën për vendimarrje me konsensus në miratimin e projektit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjeve të reformës në drejtësi. Refuzimin e saj e mbështeti publikisht edhe ambasadorja e BE në Tiranë, Romana Vlahutin, një bashkëpunëtorë e vjetër e OSF në vendin e saj. Ajo deklaroi publikisht se një marrëveshje e tillë nuk është e nevojshme.

²⁵ *Reforma në sistemin e drejtësisë. Analiza dhe strategjia*. Vëllimi I, Pjesa e Parë, faqe 18, botim i Parlamentit shqiptar, 2017, ISBN 978-9928-166-75-3. Shih gjithashtu <https://www.pressreader.com/albania/gazeta-shqiptare/20191005/281625307046673>

²⁶ *Reforma në sistemin e drejtësisë. Analiza dhe strategjia*, ibid., faqe 49.

²⁷ Skandali Soros, Reforma në Drejtësi e sponsorizuar nga fondacioni i njeriut famëkeq, drafti strategjik për kapjen e drejtësisë nga spekulanti i bursave, Sot.com.al, 30 dhjetor 2015, <https://sot.com.al/politike/skandali-soros-reforma-n%C3%AB-drejt%C3%ABsi-e-sponsorizuar-nga-fondacioni-i-njeriut-fam%C3%ABkeq-drafti>, shkarkuar në 13 korrik 2021.

1.9 Në të njëjtën linjë, edhe Komisioni i Ekspertëve të Lartë refuzoi në mënyrë të prerë përfshirjen e ekspertëve të propozuar nga opozita në këtë komision, me pretekstin absurd se ata ishin ekspertë partiakë, ndërkohë që në atë komision kishte ish-ministra, ish-zëvendës ministra dhe ish-zyrtarë të tjerë të lartë të PS. Ekspertët e opozitës në tërësi nuk u lejuan të merrnin pjesë në mbledhjen e Komisionit të Ekspertëve të Lartë, por, edhe në ato pak mbledhje ku morën pjesë, nuk kishin të drejtë të paraqisnin drafte nenesh dhe as të drejtë vote për miratimin e tyre. Ata shërbyen si ekspertë për deputetët e opozitës, dhe anëtarët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

1.10 Me gjithë refuzimin e mazhorancës dhe të Komisionit të Ekspertëve të Lartë për miratimin me konsensus të projektligjeve të reformës dhe mospranimin e ekspertëve të propozuar nga opozita, kjo e fundit pranoi ftesën dhe vendosi të marrë pjesë në punimet e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë (KPPR), duke vendosur si kusht të vetëm që drafti i hartuar dhe i miratuar pa konsensus me opozitën nga KEL dhe KPPR, të dërgohej për vlerësim në Komisionin e Venecias së bashku me oponencën e opozitës për këtë draft dhe palët të pranonin rekomandimet e këtij komisioni. Fillimisht qeveria refuzoi propozimin e opozitës për të pranuar si arbitër Komisionin e Venecias, por, me ndërhyrjen e përfaqësuesve të SHBA dhe BE, ky kusht u pranua.

1.11 Deputetët e opozitës u angazhuan me qëllimet më të mira dhe bënë gjithçka që kjo reformë të konsolidonte një sistem drejtësie të pavarur dhe të mos përdorej nga qeveria për shndërrimin e këtij sistemi në degë të ekzekutivit. Por pas fillimit të punës u bë shumë shpejt e qartë se Komisioni i Ekspertëve të Lartë po projektonte një model *sui generis* të sistemit të drejtësisë, i cili nuk ekzistonte në asnjë vend tjetër të botës dhe që kishte si qëllim kapjen dhe vendosjen e sistemit të drejtësisë nën kontrollin e qeverisë së Partisë Socialiste.

1.12 Në tetor të vitit 2015, pas përfundimit të hartimit të ndryshimeve kushtetuese nga Komisioni i Ekspertëve të Lartë (KEL) dhe miratimit të tyre vetëm nga mazhoranca, paketa e tyre u dërgua në Komisionin e Venecias së bashku me oponencën e hartuar nga opozita. Në dhjetor të atij viti Komisioni i Venecias rrëzoi 37 nga 63 nenet e draftit të paketës së ndryshimeve kushtetuese të hartuara nga KEL, sepse ato ishin në kundërshtim me parimet ndërkombëtare të pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe e vendosnin qartas këtë sistem në varësi të ekzekutivit. Ndërsa oponenca e opozitës ndaj këtij projekti, në tërësi, përputhej me rekomandimet e Komisionit të Venecias²⁸.

²⁸ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), Interim Opinion On The Draft Constitutional Amendments On The Judiciary Of Albania, Opinion No. 824 / 2015, date 21.12.2015, miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin e saj të 105, 18-19 dhjetor 2015
[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2015\)045-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2015)045-e) shkarkuar më 20 korrik 2021.

1.13 Pas dështimit të parë mazhoranca përsëri nuk pranoi të punojë me konsensus me opozitën dhe në janar të vitit 2016 dërgoi në Komisionin e Venecias draftin e saj të ri të paketës së ndryshimeve kushtetuese, të përgatitur nga KEL dhe miratuar në Komisionin e Posaçëm Parlamentar vetëm me votat e saj. Së bashku me të u dërgua edhe opopenca e opozitës ndaj këtij drafti.

1.14 Në mars të vitit 2016 Komisioni i Venecias shqyrtoi dhe rrëzoi një numër amendamentesh të draftit të dytë të kësaj pakete, duke i konsideruar ato përsëri si mjet për vendosjen e drejtësisë nën kontrollin e ekzekutivit, ndërsa opopenca e opozitës edhe kësaj here, në tërësi, përputhej me rekomandimet e Komisionit të Venecias²⁹.

1.15 Pas këtyre dy dështimeve mazhoranca u detyrua të pranojë në parim të nisë punën për hartimin me konsensus me opozitën të neneve të paketës kushtetuese dhe ligjeve organike të reformës së sistemit të drejtësisë, duke u bazuar tashmë në rekomandimet e Komisionit të Venecias.

1.16 Por OSF, organizata të shoqërisë civile të financuara nga OSF, mediat e kontrolluara nga qeveria, madje edhe vetë direkti ambasadori Lu, u angazhuan në një fushatë propagande për të mbuluar përpjekjet e tyre flagrante për kapjen e drejtësisë, të evidentuara nga rrëzimi i drafteve prej Komisionit të Venecias, duke u përpjekur të paraqisnin mazhorancën si forcën e interesuar për reformën në drejtësi dhe opozitën si kundërshtarë të saj. Argumenti i vetëm i tyre ishte kërkesa e palëkundur e opozitës që të zbatoheshin plotësisht rekomandimet e Komisionit të Venecias kundër kapjes së sistemit të drejtësisë³⁰.

1.17 Në këtë kontekst, nga fillimi i muajit prill deri në datën 21 korrik 2016 grupi i Ekspertëve të Lartë, mazhoranca në Komisionin e Posaçëm, por edhe vetë ambasadori Lu, bënë gjithçka që opozita të hiqte dorë nga rekomandimi 88(1) i Komisionit të Venecias, apo rekomandimi i *vendeve të rezervuara*, i cili për të shmangur kapjen e sistemit nga mazhoranca rekomandonte: “Nëse partitë politike nuk arrijnë në një konsensus për një shumicë të kualifikuar për zgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të reja, ato mund të zgjedhin një sistem proporcional që garanton përfaqësimin e opozitës në trupat e reja që do të formohen”³¹. Mazhoranca refuzonte në mënyrë kategorike këtë

²⁹ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), Final Opinion On The Revised Draft Constitutional Amendments On The Judiciary (Of 15 January 2016) Of Albania, Opinion No. 824 / 2015, miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin plenar të 106, Venecia, 11-12 mars 2016. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)009-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)009-e) shkarkuar më 20 korrik 2021.

³⁰ ibid., [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)009-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)009-e), §88 (pika e parë).

³¹ ibidem.,

rekomandim të Komisionit të Venecias dhe insistente në vendosjen e filtrave të kontrolluar prej saj për përzgjedhjen e kandidaturave që do të emëroheshin në organet drejtuese të sistemit të drejtësisë. Për çbllokimin e gjendjes ndërhyrë direkt zj Viktoria Nuland, Assistant Secretary of State for European and Eurasian Affairs, e cila javën e dytë të qershorit 2016, gjatë një vizite në Tiranë, arriti të çbllokojë situatën me anë të një propozimi i cili ruante plotësisht rekomandimin 88/1 të Komisionit të Venecias³². Por përsëri, edhe pas kësaj, mazhoranca vazhdoi e vendosur në përpjekjet e saj për të bllokuar formulën për vendet e rezervuara, deri dhe dy orë para votimit të paketës kushtetuese.

1.18 Presionet ndaj opozitës për të hequr dorë nga formula e vendeve të rezervuara të rekomandimit 88(1) kulmuan me protestën e organizuar para parlamentit në datë 19 korrik 2016 nga një grup të rinjsh, në krye të së cilës qëndronte ambasadori i SHBA, Donald Lu, i cili, në përpjekje për ta paraqitur opozitën si bllokuese të reformës, doli me megafon para demonstruesve duke i bërë thirrje liderit të opozitës, Basha, të mbante fjalën dhe të miratonte amendamentet që kërkonte mazhoranca³³. Kjo e fundit ishte kategorikisht kundër rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe insistente në vendosjen e filtrave të kontrollit në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për vendet drejtuese të sistemit të drejtësisë.

1.19 Përveç kësaj ambasadori Lu, me qëllim që të siguroheshin votat për miratimin e amendamenteve siç dëshironte mazhoranca, dhe faktikisht në kundërshtim me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe propozimin e vetë zj Viktoria Nuland, ndërmori një fushatë kërcënimesh të shumëllojta dhe dërgoi mesazhe kërcënuese ndaj disa deputetëve të PD, mesazhe që u publikuan edhe në media për të nxitur rebelim tek anëtarët për qëndrimin parimor të kësaj partie³⁴.

1.20 Për çbllokimin e situatës u angazhuan përsëri personalisht direkt ambasadorja Viktoria Nuland, Komisioneri për Fqinjësinë dhe Zgjerimin i Komisionit Europian, Johannes Hahn, zyrtarë të lartë të kancelarisë gjermane dhe deputetë të Bundestagut gjerman, të cilët mbështetën qëndrimin e drejtë të opozitës ndaj rekomandimit 88(1) të Komisionit të Venecias. Përveç këtyre, nga mazhoranca u shkëput aleatja e saj, Lëvizja Socialiste për Integrim, përfaqësuesit e së cilës mbështetën qëndrimin e opozitës, gjë që bëri të mundur që në datën 26 korrik 2016 drafti i amendamenteve kushtetuese të reformës të sistemit të drejtësisë të votohet unanimisht në parlament. Të nesërmen e këtij

³² [Statements by Assistant Secretary of State for European and Eurasian Affairs Victoria Nuland | U.S. Embassy in Albania \(usembassy.gov\)](#) shkarkuar më 30 gusht 2021.

³³ Report TV - Drejtësia/ Lu: Kush nuk voton pasoja të rënda nga SHBA-të, 19 korrik 2016, shkarkuar më 18 korrik 2021 https://www.youtube.com/watch?v=_yT61G1ZPPw&feature=share

³⁴ Gazeta Panorama, date 2 Gusht 2016, <http://www.panorama.com.al/intervista-sms-te-e-ambasades-se-shba-pollo-nuk-jemi-terroriste/>; JOQ, 30 Maj 2018, <https://joq-albania.com/artikull/377066.html> shkarkuar më 18 korrik 2021

votimi, duke vlerësuar lart rolin thelbësor të opozitës në këtë reformë, liderit të saj, L. Basha, i telefonuan dhe e përgëzuan Kancelarja Angela Merkel, Viktoria Nuland, Komisioneri i Fqinjësisë dhe Zgjerimit të Komisionit European, J.Hahn etj.

2. Kundërshtimi i vendosur I opozitës ndaj kapjes së plotë të sistemit të drejtësisë nga Partia Socialiste

2.1 Opozita ka kundërshtuar fort të gjithë procesin e kapjes së plotë të sistemit të drejtësisë nga mazhoranca pas votimit të paketës kushtetuese nëpërmjet dy ligjeve organike të reformës së këtij sistemi, ligjit të organeve të qeverisjes të sistemit të drejtësisë dhe ligjit të vetingut.

Fill pas votimit me unanimitet të paketës kushtetuese, qeveria, në kundërshtim me marrëveshjen e arritur midis palëve për miratimin dhe votimin konsensual jo vetëm të paketës së ndryshimeve kushtetuese, por edhe të ligjeve organike të reformës së drejtësisë dhe me qëllimin e vetëm kapjen e këtij sistemi, vendosi votimin e ligjeve organike vetëm me votat e saj. Ajo riktheu në ligjin e qeverisjes së organeve të sistemit të drejtësisë nenet për krijimin e organeve-filtra, të rrëzuara nga Komisioni i Venecias dhe të refuzuara nga opozita. Me këto filtra ajo do të kontrollonte përzgjedhjen e kandidatave që do të propozoheshin nga shoqëria civile, universitetet dhe avokatia për anëtarë të organeve drejtuese të sistemit të drejtësisë.

Në këtë frymë në datën 6 tetor 2016, vetëm 24 orë para votimit, u paraqitën nga një deputet i vetëm i mazhorancës 103 amendamente për ligjin e organeve drejtuese të sistemit të drejtësisë, me të cilat ky ligj u ndryshua plotësisht. Kjo manovër u bë me miratimin e plotë në heshtje të Komisionit të Ekspertëve të Lartë, por edhe të ambasadorëve Donald Lu dhe Romana Vlahutin. Opozita pas miratimit të këtij ligji nga mazhoranca e dërgoi atë në Gjykatën Kushtetuese, e cila në atë kohë kishte vetëm 7 nga 9 gjykatës që duhej të kishte. Gjykata u shpreh me shumicën e anëtarëve të pranishëm kundër filtrave dhe votoi në raport 4 me 3 për rrëzimin e tij. Por ligji mbeti në fuqi *ex lege*, pasi për rrëzimin e tij vendimi kërkonte 5 vota kundër. Gjatë gjithë kohës së procesit të gjykimit të ligjit, në sallën e Gjykatës Kushtetuese, në një akt presioni të hapur, ishin të pranishëm ambasadorët e SHBA dhe BE³⁵.

Pas miratimit të bazës ligjore për realizimin e kapjes së sistemit të drejtësisë, qeveria nisi zbatimin e këtij procesi dhe për këtë qëllim ajo si fillim vendosi njerëzit e saj

³⁵ Kushtetuesja shqyrton sot rrëzimin e Vettingut, ambasadori Lu hyn në seancë, 21.12.2016, shkarkuar më 9 gusht 2021, <https://www.syri.net/amp/index.php?id=14585>

besnikë në krye të trupave-filtra që do të përzgjidhnin kandidaturat nga shoqëria civile, universitetet dhe avokatia, të cilat do t'i dërgoheshin parlamentit për t'i emëruar në organet e reja drejtuese të sistemit të drejtësisë.

- Kështu Sokol Sadushi, anëtar i Komisionit të Ekspertëve të Lartë, i cili më parë kur kishte qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, në shkelje të ligjit të asaj gjykate, merrte pjesë në mbledhje të Partisë Socialiste kur kjo ishte në opozitë, tashmë në funksionin e drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, kryesoi trupën që do të përzgjidhte kandidaturat nga universitetet e vendit.

- Ardian Dvorani, anëtar i Komisionit të Lartë të Ekspertëve të Reformës, i cili duke qenë anëtar i Gjykatës së Lartë, në shkelje të ligjit të asaj gjykate merrte pjesë në mbledhje të Partisë Socialiste kur kjo ishte në opozitë, u emërua si drejtues i trupës për përzgjedhjen e kandidaturave nga shoqëria civile. *De facto* çdo mbledhje të kësaj trupe e kryesoi, me delegim, drejtori ekzekutiv i Fondacionit të Shoqërisë së Hapur në Tiranë, Andi Dobrusha.

- Maks Haxhia, kreu i Dhomës së Avokatëve, i implikuar në një aferë antiligjore shumë milionë euro direkt me Edi Ramën për ndërtesën e shkollës së avokatisë, aferë e denoncuar disa herë nga media, kryesoi trupën që do të përzgjidhte, sipas orekseve të Edi Ramës, kandidaturat që duhej të vinin nga avokatia³⁶.

Të tre këto trupa në procesin e përzgjedhjes së kandidaturave nuk respektuan Kushtetutën, ligjin dhe përdorën standarte të dyfishta. Ato në shumë raste përzgjedhën persona që nuk plotësonin kriteret kushtetuese ose ligjore minimale, ish-prokurore, ish-gjykatës dhe ish-hetues në gjyqet politike të diktaturës komuniste, ish-bashkëpunëtorë të policisë sekrete të regjimit, ish-ministra të Partisë Socialiste, persona në konflikt të hapur interesi dhe të tjerë që ishin ndëshkuar nga autoriteti tatimor apo nuk vërtetonin se kishin shlyer rregullisht detyrimet tatimore. Të gjitha këto mangësi ishin kushte kushtetuese ose ligjore për skualifikimin e tyre. Së fundi, përmend se edhe ONM (Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit) i ka vlerësuar shumicën dërrmuese të kandidatëve të përzgjedhur si juristë të një niveli “mesatar”, ndërkohë që Kushtetuta përcaktonte qartë se ata duhej të ishin “juristë të spikatur”.

Kushtetuta përcaktonte se sekretari i përgjithshëm i parlamentit në marrëveshje me ONM duhej të përzgjidhnin kandidaturat, të cilat do t'i dërgoheshin parlamentit për t'i emëruar në organet drejtuese të drejtësisë. Në kundërshtim me këtë parashikim, sekretari

³⁶ Exit.al, 28.08.2019, Who Paid for the New Justice HQ?, <https://exit.al/en/2019/08/29/who-paid-for-the-new-justice-hq/> shkarkuar më 22 gusht 2021. Shih edhe Skandali me godinën e re të Drejtësisë. Gazetari denoncon: U ndërtua për 2 milionë euro në token e shtetit, Qeveria e bleu 12.6 Milionë euro. Date 07.05.2020, <http://www.panorama.com.al/skandali-me-godinën-e-re-te-drejtësisë-gazetari-denoncon-u-ndertua-per-2-milion-euro-ne-token-e-shtetit-qeveria-e-bleu-12-6-milion-euro/> , shkarkuar më 22 gusht 2021

i përgjithshëm i parlamentit, Genc Gjonçaj, një ish-drejtues i PS, i paraqiti parlamentit lista në të cilat një pjesë e mirë e kandidatëve nuk plotësonin kriteret kushtetuese ose ato ligjore minimale dhe që ishin kundërshtuar nga ONM, por që kishin besimin e Partisë Socialiste. Opozita, duke i konsideruar të pavlefshme këto lista, ngriti padi ndaj tij për shkelje të Kushtetutës.

Së fundi i gjithë procesi i përzgjedhjes së kandidaturave nga trupat filtruese dhe nga sekretari i përgjithshëm u realizua pa monitorimin e rëndësishëm të Komisionit të Pavarur të Monitorimit, detyra ligjore e të cilit ishte monitorimi i proceseve të përzgjedhjes së kandidatëve që do t'i dërgoheshin parlamentit për t'i emëruar si anëtarë të organeve të qeverisjes të sistemit të drejtësisë. Kjo ndodhi sepse kuvendi në kundërshtim me ligjin dhe për të shmangur këtë monitorim nuk e krijoi asnjëherë këtë komision.

2.2 Opozita ka mbajtur qëndrim kritik ndaj kapjes të organeve më të larta drejtuese të sistemit të drejtësisë, KED, KLP, KLGJ dhe ILD.

Të gjitha emërimet e drejtuesve të institucioneve të reja u bënë në shkelje të hapur të kriterëve kushtetuese apo ligjore, në kushtet e konfliktit të interesit dhe duke aplikuar standarte të dyfishta, me qëllimin e vetëm kapjen nga qeveria të drejtimit të këtyre organeve. Le t'u referohemi fakteve.

2.2.1 Tre drejtuesit e institucioneve më të larta të sistemit të drejtësisë, z.Dvorani, z.Sadushi, z.Ibrahimi, znj.Vorpsi dhe të tjerë, si z.I.Panda, anëtarë të Komisionit të Ekspertëve të Lartë, u emëruan në këto poste duke shkelur marrëveshjen e arritur midis palëve, sipas së cilës për të përjashtuar konfliktin e interesit, asnjë nga anëtarët e Komisionit të Ekspertëve të Lartë (KEL) nuk do të kandidonte për një periudhë 6-vjeçare për poste në sistemin e drejtësisë. Kjo sepse, ndër avantazhet e tjera, ata në ligje kishin vendosur për këto poste paga 15 herë më të larta sesa paga mesatare e vendit.

2.2.2 Në krye të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, KED, organit që përzgjedh kandidaturat për gjykatës në Gjykatën Kushtetuese, të cilat më pas emërohen nga presidenti i republikës dhe parlamenti, si dhe kandidaturat për ILD, që më pas emërohen nga parlamenti, u vendos një bashkëpunëtor i Fondacionit Shoqëria e Hapur dhe anëtar i Grupit të Ekspertëve të Lartë të reformës të sistemit të drejtësisë, Ardian Dvorani. Ai është një ish-hetues i zellshëm i regjimit komunist, i cili më 13 dhjetor 1990 terrorizoi në hetuesi të rinjtë e Shkodrës që rrëzuan në këtë qytet bustin e Stalinit dhe kërkoi dënimin e

tyre deri në 15 vjet burg “për akte terroriste kundër pushtetit popullor”³⁷. Në kundërshtim me ligjin e lustracionit, A. Dvorani u përzgjedh nga ish-komunistët, në shkurt të vitit 2005, gjykatës në Gjykatën e Lartë me mandat 9-vjeçar. Pas skadimit të mandatit, në kundërshtim me një vendim të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016, që e detyronte të largohej nga gjykata, ai qëndroi në detyrë deri në vitin 2020, kur KLGJ e shkarkoi me një vendim të veçantë³⁸. Kjo pasi Komisioni i Venecias në raportin e tij nr.978/2020, datë 19 qershor 2020, argumentoi se Dvorani, si kryetar i KED kishte shkelur ligjin dhe Kushtetutën³⁹. Komisioni i Venecias ka vënë në dukje se Dvorani me veprimet e tij ka penguar transparencën e punës së KED. Në raportin e Komisionit të Venecias vihet në dukje se, me nenin 41 të rregullores së KED, u shkel Kushtetuta dhe ligji kur u pengua Avokati i Popullit të kryejë detyrimin e tij kushtetues të monitorimit të mbledhjeve dhe operacioneve të KED⁴⁰. Raporti përmend gjithashtu se Dvorani shkeli ligjin që e detyron të regjistrojë në audio, debatet në mbledhjen e KED dhe të publikojë përmbledhjen e tyre në website-in e Gjykatës së Lartë. Përveç këtyre komisioni gjeti se Dvorani “nuk informoi anëtarët e KED dhe nuk vendosi në mbledhje, siç e kërkon ligji, por vendosi vetë për radhën e dërgimit të listave të kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese nga Presidenti i Republikës dhe Parlamenti”. Me këto veprime Dvorani e futi vendin në një krizë të thellë kushtetuese, duke bërë, sipas Komisionit të Venecias, që të gjitha emërimet në Gjykatën Kushtetuese, përveç njërit, të jenë potencialisht jo kushtetuese⁴¹. Pavarësisht këtyre konstatimeve të Komisionit të Venecias, Departamenti i Shtetit e përzgjedhi Dvoranin si një nga kampionët e reformës në drejtësi në Shqipëri⁴².

Procesi i vetingut të Ardian Dvoranit është rasti klasik i përdorimit të dy standarteve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) në vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të pasurisë. Gjatë këtij procesi doli se Dvorani nuk kishte deklaruar 82 mijë

³⁷ Fakti është denoncuar nga Partia Demokratike dhe është trajtuar gjerësisht në media. [Dvorani, the communist prosecutor, today a senior judge who does not release the chair 6 years after the end of his term - Exit | Explains Albania](#), [Dvorani, prokurori që kërkoi dënimin për terrorizëm të organizatorëve që rrëzuan bustin e Stalinit | BoldNews.al](#) shkarkuar më 2 gusht 2021.

³⁸ <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-11-qershor-2020/> shkarkuar në 30 gusht 2021.

³⁹ Raporti i Komisionit të Venecias, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2020\)010-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2020)010-e), §90, §105.

⁴⁰ Shih për shembull rekomandimet e Komisionit të Venecias, ibidem, §104.

⁴¹ Draft raporti i Komisionit të Venecias, i dates 6 mars 2020, Mbi emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, §70.

⁴² <https://www.facebook.com/usembassytirana/posts/10158173721185838/>, <http://ata.gov.al/2021/04/07/palmer-me-kampionet-e-reformes-ne-drejttesi-shba-krah-jush-ndersa-ndryshoni-kulturen-e-ngulitur-te-korrupsionit-dhe-pandeshkueshmerise/>, shkarkuar më 30 gusht 2021.

euro të vetat dhe të familjes së tij. Ai e justifikoi këtë me harresën e ekzistencës së tyre dhe çuditërisht kjo “harresë” u pranua edhe nga komisionerët e KPK, ndërsa, për shembull, pak më vonë anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, Besnik Muçi, të emëruar nga Presidenti i Republikës, nuk iu pranua “harresa” për 16 mijë euro dhe ai u largua nga detyra. Përveç kësaj në kontrast me qëndrimin mbi “harresën” e Dvoranit, KPK konsideroi se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, F.Hoxha, kishte kryer fshehje të pasurisë duke mos përmendur në deklaratën vjetore të vitit 2003 një depozitë të bashkëshortes në vlerën prej 330.000 lekësh (afërsisht 2500 euro), të cilën ai e kishte deklaruar më vonë, në vitin 2004, dhe vendosi shkarkimin e tij⁴³. Po kështu, KPK vendosi shkarkimin e gjyqtarit B.Trezhnieva duke përmendur, ndër të tjera, se ai kishte kryer fshehje të pasurisë kur nuk kishte përmendur në deklaratën e tij të pasurisë llogarinë bankare të së bijës, të krijuar tërësisht nga rroga e saj në një institucion shtetëror, e gjitha në vlerën rreth 1000 euro (148.226 lekë)⁴⁴.

Po kështu, apartamenti i përfituar nga Dvorani në vitin 2001, si punonjës i kompanisë shtetërore Albtelekom sh.a. paraqiti probleme të theksuara të transparencës dhe konfliktit të interesit. Apartamenti, i cili sipas kontratës fillestare ishte 93 m2, në hipotekë ishte regjistruar në emër të një personi tjetër. Pagesa e apartamentit ishte bërë fillimisht nga Dvorani (me këste që prej vitit 2004), por pas privatizimit të kompanisë, në 2013, partnerët privatë të Albtelekomit vendosën t’i falnin Dvoranit, i cili në atë kohë ishte gjyqtar në Gjykatën e Lartë, vlerën e mbetur prej 17 mijë eurosh, nga 34 mijë që ishte vlera totale, dhe gjithashtu t’i ofrojnë një sipërfaqe shtesë, duke e bërë kështu apartamentin në total 120 m2. Si justifikim të vetëm për këtë KPK pranoi argumentin se Albtelekomi e kishte bërë këtë me vullnetin e vet dhe jo me kërkesë të A. Dvoranit. Ndërkohë Dvorani kishte gjykuar në Gjykatën e Lartë, në konflikt të plotë interesi si kryetar apo anëtar paneli, 9 çështje ku palë ishte Albtelekomi kundër institucioneve shtetërore, taksave, entit rregullator të telekomunikacionit etj. dhe në të gjitha ai kishte votuar në favor të Albtelekomit⁴⁵. Për kontrast janë të shumtë gjyqtarët që janë larguar vetëm sepse kreditë e tyre, të marra në banka private, janë konsideruar si të dhëna në

⁴³ Vendimi nr.18 i KPK, datë 10.05.2018, gjithashtu i raportuar në raportin studimor mbi vendim-marrjen e institucioneve tranzitore të ri-vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për periudhën shkurt – tetor 2018, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nëntor 2018, faqe 15.

⁴⁴ Vendimi nr.14 i KPK, datë 13.04.2018, gjithashtu i raportuar në raportin studimor mbi vendim-marrjen e institucioneve tranzitore të ri-vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për periudhën shkurt – tetor 2018, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nëntor 2018, faqe 18.

⁴⁵ Vendimet i Gjykatës së Lartë (kolegjet civile ose administrative): vendim Nr. 00-2016-3378, datë 24.11.2016, vendim nr.00-2013-734, datë 18.12.2012, vendim nr.00-2013-332, datë 05.02.2013, vendim nr.00-2016-1128, datë 24.03.2016, vendim nr. 00-2015-1898, datë 20.05.2015, vendim nr. 00-2015-2873, datë 05.05.2015, vendim nr.00-2012-2734, datë 13.11.2012, vendim nr. 00-2011-2302, datë 22.11.2011, vendim nr. 00-2019-298, datë 30.04.2019

kushte më të favorshme se ato të tregut, apo kur ata kanë gjykuar çështje në të cilat palë kanë qenë bankat ku ata kanë marrë kredi.

Përveç kësaj, në një tjetër çështje penale me profil të lartë, u mësua për një regjistrim në të cilën një palë e interesuar thoshte se Dvorani do të votonte në favor të tyre. Pasi ekzistenca e regjistrimit u mësua, Dvorani votoi për palën tjetër. Pavarësisht sa më sipër, në shkurt 2021 Ardian Dvorani u shpall nga Departamenti i Shtetit si një nga dhjetë kampionët botërorë të luftës kundër korrupsionit⁴⁶ dhe në prill 2021 si një nga kampionët e reformës në drejtësi në Shqipëri⁴⁷.

2.2.3 Zgjedhja e Sokol Sadushit si zëvendës kryetar i Gjykatës së Lartë ishte po ashtu në shkelje të ligjeve. Ai ishte anëtar i Grupit të Ekspertëve të Lartë të reformës në drejtësi dhe ka qenë prokuror i regjimit komunist. Në muajin prill të vitit 1998, në kundërshtim me ligjin e lustracionit, Sadushi zgjidhet nga mazhoranca ish-komuniste si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, detyrë të cilën e përfundon në korrik të vitit 2011. Ai së bashku me Dvoranin, në kundërshtim me ligjin, ka marrë pjesë në takime publike të Partisë Socialiste kur kjo ishte në opozitë. Në vitin 2020 Sadushi u emërua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) anëtar i Gjykatës së Lartë dhe më pas zëvendës kryetar i kësaj gjykate e cila deri tani nuk ka kryetar. Sadushi nuk kaloi në proces vetingu nga KPK dhe as KLGJ nuk bëri vetingun e tij para emërimit. KLGJ, pas emërimit të tij si anëtar i Gjykatës së Lartë, deklaroi se kishte bërë vetingun e tij, por në një rast unik, deri sot nuk ka publikuar të dhënat e këtij procesi, i cili mbahet sekret.

Si për ironi, problemet serioze të pasurisë së Sokol Sadushit dolën gjatë vetingut nga KPK te Zj Edlira Petri, bashkëshorte e tij, gjykatëse në gjykatën e apelit Tirane. Sadushi kishte deklaruar shitjen e një apartamenti për 55 mijë euro, por çuditërisht shitja jo vetëm nuk qe deklaruar në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme sipas ligjit, por në të njëjtën kohë apartamenti që Sadushi pretendonte të kishte shitur, rezultonte i regjistruar si kolateral në favor të Sadushit, për të siguruar një kredi bankare të marrë prej tij. Gjyqtarja e KPK, që doli me vendim pakice në këtë proces vetingu, vë në dukje gjithashtu se pala që pretendohet se kishte blerë apartamentin nuk kish provuar se kishte pasur mundësi financiare të paguante 55 mijë euro, të cilat pretendohet të jenë paguar jashtë sistemit bankar. Trupa gjyqësore e KPK u nda në qëndrimin e saj edhe në lidhje me vlerësimin e origjinës së 20 mijë eurove para cash të deklaruar nga Sadushi si të trashëguara, si dhe për dokumentet provuese të faktit se operimi i vajzës së Sadushit në SHBA ishte bërë falas. Kolegji pranoi si dokument provues të shpenzimeve shëndetësore

⁴⁶ <https://ne-np.facebook.com/usembassytirana/posts/10158073280525838> , <https://www.zeriamerikes.com/a/5789554.html> , shkarkuar më 30 gusht 2021.

⁴⁷ <https://www.facebook.com/usembassytirana/posts/10158173721185838/> shkarkuar më 30 gusht 2021.

e-maile, përfshirë një komunikim nga kirurgu pediatrik që kishte kryer ndërhyrjen në spitalin në SHBA, ndërkohë që, sikundër vë në dukje gjykatësja e pakicës në KPK, praktika e përcaktuar nga KPK dhe KPA në raste të tjera i ka gjetur të papranueshme si prova aktet që nuk kishin elementët formalë të njohjes së një dokumenti të lëshuar nga një vend i huaj, dhe ka vendosur përjashtimin e gjyqtarëve në fjalë nga sistemi i drejtësisë⁴⁸.

Po kështu, gjykatësja e pakicës, në mendimin e saj vë në dukje se të ardhurat e çiftit nuk mbulonin shpenzimet e deklaruara për një shtesë apartamenti në Tiranë dhe mobilimin e saj⁴⁹. Në përfundim, znj. Petri e kaloi vetingun me një vendim të marrë me votat e dy prej tre gjyqtarëve të KPK, në të cilin shumica dhe pakica nuk ranë dakord për pjesën më të madhe të aspekteve të kontrollit pasuror dhe ky është i vetmi rast vetingu i kaluar me vendim jo unanim, të cilin Komisioneri Publik nuk e ka apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA), por, duke aplikuar një standart të dyfishtë, la në fuqi vendimin e KPK.

Kjo shpjegon qartë se përse KLGJ prej dy vjetësh mban sekret, në shkelje flagrante të Kushtetutës dhe ligjit, rezultatin e vetingut të zëvendës kyetarit të Gjykatës së Lartë, Sokol Sadushi.

2.2.4 Zgjedhja në krye të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) e Gent Ibrahimit, kunati i Mimi Kodhelit, ish-ministres së mbrojtjes dhe deputetes së PS deri në vitin 2021, si dhe një ish-përfaqësues i OSF Albania⁵⁰. Ibrahimimi ishte gjithashtu anëtar i grupit të Ekspertëve të Lartë të reformës në drejtësi. Ai u emërua në postin që mban, në kundërshtim me Kushtetutën, sepse ai ishte i skualifikuar nga ONM, por pavarësisht nga kjo, Ibrahimimi me lidhjet politike e kaloi këtë pengesë kushtetuese, ndërkohë që të tjerët, për të njëjtën arsye, u përjashtuan nga sistemi i drejtësisë. Në deklaratën e tij të vetingut atij i janë pranuar si të ardhura të ligjshme tridhjetë e pesë mijë euro dhuratë nga prindërit, ndërkohë që gjyqtarëve e prokurorëve që kanë kaluar në procesin e vetingut nuk u janë njohur si të ardhura të ligjshme dhuratat nga prindërit edhe në shuma më të vogla, ndonëse me burime të qarta.

⁴⁸ Mendimi i pakicës në vendimin e KPK nr.262, datë 17.6.2020, §24-24.5. Në lidhje me qëndrimin e KPA shih vendimin nr.9 të KPA, datë 24.10.2018, si dhe raportin studimor mbi vendim-marrjen e institucioneve tranzitore të ri-vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për periudhën shkurt – tetor 2018, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nëntor 2018, faqe 11.

⁴⁹ Mbi faktet e vetingut të znj. Edlira Petri, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë shih vendimin e KPK nr. 262, datë 17.06.2020, mendimi i gjyqtarit të pakicës <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/07/Mendim-Pakice.pdf>, shkarkuar më 22 gusht 2021.

⁵⁰ *Reforma në sistemin e drejtësisë. Analiza dhe strategjia*. Vëllimi I, Pjesa e Parë, faqe 157, botim i Parlamentit Shqiptar, 2017, ISBN 978-9928-166-75-3.

2.2.5 Inspektor i lartë i drejtësisë (ILD) u emërua Artur Metani, vëllai i ish-ministres së PS E. Gjermani, i cili kishte qenë anëtar i grupit të Ekspertëve të Lartë të reformës së drejtësisë. Më parë ai kishte punuar si përfaqësues i OSF dhe ish-këshilltar i Presidentit të Republikës dhe i Kryeministrit Rama⁵¹. Metani u emërua në këtë post në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, pasi këshilltarët e presidentit dhe kryeministrit, sipas ligjit, konsiderohen funksionarë të lartë politikë dhe si të tillë nuk mund të zgjidhen në funksione si ILD, ku ligji kërkon kandidatë të palidhur politikisht. Në fakt, pikërisht në bazë të këtij argumenti, KED rrëzoi kandidatura të tjera, por në rastin e A.Metanit mbajti haptas qëndrim të kundërt (për më gjerë mbi këtë çështje shih më poshtë kapjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë), duke injoruar ligjin. Pas emërimit të tij si ILD një skandal mbështolli në atë periudhë figurën e Metanit, emri i të cilit doli në regjistrimet e policisë, kur gjatë një bisede, në një hotel në Tiranë, atij i premtoheshin 500 mijë euro në këmbim të lehtësirave në Gjykatën e Lartë për një të dënuar për vrasje. Ndonëse çështja bëri bujë, emri i Metanit u fshi nga historia, mesa duket me urdhër nga lart.

2.2.6 Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, KLGJ, Naureda Llagami. Zonja Llagami u emërua në këtë post në kundërshtim me disa kriteret kushtetuese dhe ligjore. Konkretisht, Avokati i Popullit konstatoi se zj Llagami, e cila u përzgjedh nga shoqëria civile, nuk plotësonte kriterin kushtetues të eksperiencës 15-vjeçare si juriste⁵². Për mosplotësim të këtij kriteri B. Ilia dhe E. Deçka u skualifikuan nga gara. Zj Llagami nuk plotësonte as kushtin e angazhimit të pandërprerë për 5 vjet në shoqërinë civile, për të cilin të tjerë kandidatë u përjashtuan nga gara. Zonja Llagami gjatë kohës që punoi si këshilltare në Gjykatën e Lartë kishte shkëlur ligjin mbi konfliktin e interesit dhe statusin e saj, duke lidhur disa kontrata me një shoqatë të shoqërisë civile. Për të njëjtën shkëlje ligjore P. Ndreca, u skualifikua nga gara. Në dokumentet e paraqitura nga zj Llagami u konstatuan mospërputhje midis datës së deklaruar prej saj për vetëpunësim dhe datës së dokumentit tatimor. Për këto mospërputhje kandidatë të tjerë u skualifikuan. Dy nga personat që votuan për përzgjedhjen e zj Llagami ishin në konflikt interesi dhe nuk duhej të merrnin pjesë në votim.

⁵¹ CV-ja e z.Metani mund të gjendet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, shkarkuar më 16 korrik 2021, http://www.gjykataelarte.gov.al/web/artur_metani_cv_2146.pdf

⁵² Për cv-në e znj.Llagami shih <http://www.aksedrejttesi.al/dokumenta/15922285231.%20CV%20e%20zgj.%20Naureda%20Llagami.pdf> shkarkuar më 16 korrik 2021

2.2.7. Siç shpjegohet më në detaje në pikën 2.4, një tjetër eksperte e reformës në drejtësi, znj. Arta Vorpsi, e propozuar nga PS si kandidatë për gjykatëse në Gjykatën Kushtetuese, zëvendësoi detyrimin kushtetues dhe publik të betimit para Presidentit të Republikës⁵³ me betimin privat para një noteri, sipas sygjërimeve dhe mbështetjes së PS dhe disa ambasadorëve të huaj në Shqipëri. Ky është ilustrimi më flagrant i kolapsit të çdo lloj koncepti ligjor brenda reformës në drejtësi. Znj.Vorpsi është e vetmja anëtare e gjyqësorit që ka kryer ndonjëherë një shkelje të tillë flagrante të Kushtetutës, sië u konsiderua edhe nga Komisioni I Venecias⁵⁴. Megjithatë, pasi nuk u zgjodh si gjykatëse në Gjykatën Kushtetuese, ajo u punësua dhe aktualisht punon si shefe kabineti pranë kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Sadushi.

2.3 Kapja nga qeveria e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED).

Sipas Kushtetutës KED përbëhet nga 9 anëtarë, me mandat njëvjeçar, që zgjidhen me short nga radhët e gjykatësve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk ka pasur masë disiplinore. KED ka për detyrë verifikimin dhe renditjen e kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilat ua dërgon në mënyrë strikte sekuenciale për emërim, presidentit dhe parlamentit, duke renditur tri kandidatura për çdo post vakant. Ky organ gjithashtu verifikon, rendit e i dërgon parlamentit kandidaturat për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD).

Në përputhje me procedurën kushtetuese, në datë 27 janar 2017 Parlamenti zgjodhi me short KED. Por Edi Rama pasi konstatoi se me atë përbërje nuk do të mund të kontrollonte këtë organ dhe për rrjedhojë nuk mund të kapte dot Gjykatën Kushtetuese, ndërmoi në datë 31 janar ndaj anëtarëve të KED një sulm të ashpër publik dhe kërcënoi anëtarët e pa-vetuar me procesin e vetingut⁵⁵. Të nesërmen e sulmit disa anëtarë të KED, që nuk kishin bërë vetingun, dhanë dorëheqjen. Në datë 6 shkurt 2017 sulmit të Ramës ndaj KED iu bashkua ambasadori i SHBA, Donald Lu, i cili, në një deklaratë në faqen zyrtare të ambasadës, deklaroi: "Prokurori i Përgjithshëm dhunoi frymën e Kushtetutës duke dërguar një listë me vetëm tre prokurorë për të plotësuar tre pozicione"⁵⁶, ndërkohë që, pas verifikimit rezultoi se Prokuroria e Përgjithshme në rastin konkret kishte zbatuar

⁵³ Shih nenin 129 të Kushtetutës së Shqipërisë.

⁵⁴ Draft raporti I Komisionit të Venecias, 6 Mars 2020, Mbi caktimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri, §70.

⁵⁵ <http://top-channel.tv/video/rama-kunder-ked-gjysma-ikin-nga-vettingu/> shkarkuar më 30 gusht 2021

⁵⁶ Ambasadori i SHBA në Shqipëri Donald Lu në konferencën "Pjesëmarrja qytetare dhe demokracia direkte", shkurt 2017, <https://al.usembassy.gov/sq/fjala-e-ambasadorit-lu-ne-konferencen-pjesemarrja-qytetare-dhe-demokracia-e-drejtperdrejte/> shkarkuar më 30 gusht 2021.

në mënyrën më korrekte kërkesat e Kushtetutës dhe të nenit 221 të ligjit nr.115/2016. Përveç kësaj, në deklaratën e tij ambasadori i SHBA, Donald Lu, njëlloj si Rama, kërcënoi anëtarët e KED me procesin e vetingut duke u shprehur se “Disa anëtarë të Këshillit kanë dhënë dorëheqjen këtë javë, në vend që të përballeshin të parët me vetingun. Ne do të ndjekim nga afër për të parë nëse Komisioni i Vetëingut do t’i përmbahet kësaj kërkesë kushtetuese dhe nëse të gjithë anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi do ta kalojnë procesin e vetingut”⁵⁷. Për të gjitha këto KED i vitit 2017 nuk u mblodh ndonjëherë, ndërkohë që vendi ishte pa gjykatë kushtetuese.

Në datë 7 dhjetor 2017 Kuvendi hodhi përsëri shortin dhe zgjodhi Këshillin e Emërimeve në Drejtësi të vitit 2018. Sërish emrat që rezultuan nga kjo procedurë shorti nuk i pëlqyen kryeministrit Rama. Prandaj kryetari i Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë, deputet i Partisë Socialiste, Ulsi Manja, në datë 5 mars 2018 u bëri thirrje publike anëtarëve të KED-së që të kalojnë vetingun, përpara se të fillojnë nga puna për të bërë filtrin e kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese⁵⁸. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2018 u mblodh vetëm një herë, në 19 mars, ndërkohë që vendi vazhdonte pa Gjykatë Kushtetuese, pasi që në fillim të vitit 2017 të gjithë gjykatësit e saj, përveç njërit, u larguan për shkak të moskalimit të procesit të vetingut ose dhanë dorëheqjen. Dukej qartë se jo ngritja, por kapja e kësaj gjykate ishte qëllimi kryesor i qeverisë.

Pas ardhjes së A. Dvoranit në krye të KED në vitin 2019 dhe 2020 u ‘harrua’ krejtësisht vetingu për anëtarët e KED. As Rama dhe askush tjetër nuk kanë kërkuar publikisht ndonjëherë vetingun e tyre.

Blokimi i KED nga qeveria për dy vjet me radhë, për shkak të vetingut, ishte antikushtetues dhe antiligjor. Komisioni i Venecias i thirrur si arbitër në disa momente të reformës e ka cilësuar veprimtarinë e KED dhe kryetarit të saj, si një nga dy problemet serioze në zbatimin e reformës dhe funksionimin e organeve të reja. Ky komision në raportin e tij, të datës 20 qershor 2020, shkruan se: ”KED 2017 dhe 2018 nuk mund të pengoheshin në detyrën e tyre mbasi “nuk ishte e parashikuar as në Kushtetutë dhe as në ligj, që anëtarët e KED të kishin kaluar procesin e vetingut”⁵⁹.

⁵⁷ ibid.

⁵⁸ Ulsi Manja për anëtarët e KED: T’i nënshtrohen vetting-ut, para se..., Gazeta Shqiptare, 5 mars 2018, <http://gazetashqiptare.al/2018/03/05/ulsi-manja-per-anetaret-e-ked-ti-nenshtrohen-vetting-ut-para-se/>, shkarkuar më 30 gusht 2021.

⁵⁹ Raporti i Komisionit të Venecias, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2020\)010-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2020)010-e), §90-91.

2.4 Përpjekjet e kundërligjshme të qeverisë për kapjen e Gjykatës Kushtetuese.

Pas kapjes së KED në vitin 2019 qeveria e PS, nëpërmjet A.Dvoranit, nisi menjëherë përpjekjet e hapura për kapjen e Gjykatës Kushtetuese, që përbëhet nga 9 anëtarë, nga të cilët, sipas Kushtetutës, tre emërohen nga parlamenti, tre nga presidenti dhe tre nga gjykata e lartë.

Në datën 13 Prill 2019 kryetari i KED, Dvorani, pa njoftuar anëtarët e KED, u dërgoi parlamentit dhe presidentit, por duke manipuluar me kohën, radhën (sekuencën) dhe me listat, emrat e kandidatëve për të plotësuar katër vende vakante në Gjykatën Kushtetuese, dy nga presidenti dhe dy nga parlamenti. Nëpërmjet manipulimit me radhën dhe kohën e dërgimit të listave parlamentit dhe presidentit, KED i hoqi presidentit në mënyrë antikushtetuese të drejtën e emërimit të një gjykatësi dhe shpalli vetë kandidatin e pa-emëruar nga presidenti, A. Vorpsi si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Kur Presidenti i refuzoi betimin kësaj gjykatëseje, kjo e fundit, në një rast të paprecedent dhe në kundërshtim me ligjin u betua para një noteri. Qeveria publikoi brenda ditës në fletoren zyrtare emrin e saj si anëtarë e Gjykatës Kushtetuese, ndonëse ajo ishte vetëm kandidate e KED dhe nuk ishte emëruar as nga presidenti dhe as nga parlamenti. Jo vetëm kaq, por mazhoranca menjëherë nisi procedurën e shkarkimit të Presidentit me akuzë shkeljen e Kushtetutës dhe amendoi ligjin për betimin para Presidentit të gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese duke hapur mundësinë e betimit alternativ të këtyre gjykatësve.

Komisioni i Venecias, i thirrur nga palët për analizën e kësaj krize kushtetuese, në raportin e tij të mësipërm shprehej se Presidentit “nuk mund t’i cenohet e drejta kushtetuese e emërimit të tre gjykatësve”, se Presidenti kishte “interpretuar në mënyrë të arsyeshme Kushtetutën” dhe se betimi i gjykatësve nuk mund të ndryshohej. Komisioni i Venecias shprehet se kryetari KED në veprimtarinë e tij kishte cenuar transparencën dhe kishte shkelur Kushtetutën dhe ligjin dhe se neni 41 i rregullores së KED ishte në kundërshtim me kuadrin kushtetues dhe ligjor, pasi i kishte mohuar Avokatit të Popullit të drejtën kushtetuese për të marrë pjesë si vëzhgues në mbledhjet e KED⁶⁰. Raporti gjithashtu theksonte se z.Dvorani kishte shkelur ligjin pasi nuk kishte siguruar regjistrimin audio të takimeve të KED, si dhe publikimin e procesverbalit të mbledhjeve në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë.

Përveç kësaj KED, për të zgjedhur në Gjykatën Kushtetuese kandidaturat më besnike të PS, shkeli detyrimet kushtetuese mbi përgatitjen e listave të kandidatëve.

⁶⁰ Opinioni nr.978/2020 i Komisionit të Venecias mbi Shqipërinë, Mbi Emërimin E Gjyqtarëve Të Gjykatës Kushtetuese, miratuar nga Komisioni i Venecias më 19 qershor 2020, me procedure me shkrim që zëvendësoi sesionit e saj të 123, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2020\)010-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2020)010-e), §90-91

Kryetari i KED, për 4 vende vakante nuk nisi 12 kandidatura të veçanta, siç kërkon ligji, por duke vendosur një person njëkohësisht në dy dhe tre lista dërgoi vetëm 6 kandidatura për 4 vende vakante⁶¹. Ky veprim i Dvoranit sipas Komisionit të Venecias ka bërë që “të gjitha emërimet në Gjykatën Kushtetuese, përveç njërit, të jenë potencialisht jokushtetuese”⁶². Kjo sepse emërimet pa garë nga Kuvendi, në mungesë të 3 kandidatëve të vlefshëm për çdo vend vakant, nuk janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Për të gjitha këto Komisioni i Venecias shprehet se veprimtaria e KED është njëri nga dy faktorët që çrregulluan rëndë modelin në Shqipëri⁶³.

2.5 Kapja nga qeveria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) në kundërshtim flagrant me Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

Sipas Kushtetutës, kryetari i ILD duhej të ishte emëruar në shkurt–mars 2017, pra 6 muaj pasi amendamentet kushtetuese të reformës në drejtësi hynë në fuqi. Por kjo nuk ndodhi, sepse qeveria bllokoi, siç është shpjeguar më sipër, për dy vjet me radhë funksionimin e KED.

Ndaj dhe procedurat për emërimin e ILD filluan vetëm pasi ajo realizoi kapjen e KED me anë të Dvoranit, i cili do të siguronte emërimin në atë funksion të kandidaturës së paracaktuar nga qeveria, Artur Metanit. Në janar të vitit 2020 Parlamenti i Shqipërisë zgjodhi, nga një listë e dërguar prej KED, Inspektor të Lartë të Drejtësisë (ILD) Artur Metanin, vëllain e ish-ministres së PS (E. Gjermani), i cili kishte qenë anëtar i grupit të Ekspertëve të Lartë të reformës në drejtësi dhe më parë kishte punuar si përfaqësues i OSF, ish-këshilltar i Presidentit të Republikës dhe më vonë këshilltar i Kryeministrit Rama⁶⁴.

Metani u emërua në këtë post në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e vendit dhe me aplikim flagrant të standartit të dyfishtë. Sipas Kushtetutës (nenit 147/d/40, pika 3) personi që emërohet në organet e larta të drejtësisë “...nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit”. Kurse ligji i shërbimit civil, (neni 3 dhe 4) si

⁶¹ ibid., §92-97

⁶² Draft raporti i Komisionit të Venecias, i dates 6 Mars 2020, Mbi Emërimin E Gjyqtarëve Të Gjykatës Kushtetuese, §70.

⁶³ ibidem, §77.

⁶⁴ Për cv-në e z.Metani shih http://www.gjykataelarte.gov.al/web/artur_metani_cv_2146.pdf shkarkuar më 16 korrik 2021.

dhe ai i Këshillit të Ministrave (neni 4), e përjashtojnë këshilltarin nga statusi i nëpunësit të shërbimit civil dhe e cilësojnë si funksion politik⁶⁵.

Bazuar mbi këto përcaktime KED përjashtoi nga gara për anëtar të Gjykatës Kushtetuese ish-këshilltarin e Presidentit dhe ish-gjykatësin Shaqir Hasani, por miratoi për kryetar të ILD ish-këshilltarin e Presidentit dhe Kryeministrit, Artur Metanin. Kështu KED, me vendimin e tij nr. 100, dt. 30.07.2019 vendosi lejimin e kandidatit Artur Metani, ish-këshilltar i Presidentit dhe i Kryeministrit Rama për të vijuar garën për inspektor të lartë të drejtësisë, duke argumentuar se: “Këshilli konkludon që funksioni i këshilltarit juridik të Presidentit të Republikës nuk mund të konsiderohet si funksion politik, në kuptim të ligjit 115/2016” dhe se ai “...nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit...”. Ndërkohë që me vendimin nr. 15, dt. 17.07.2020, KED skualifikon nga gara për anëtar të Gjykatës Kushtetuese ish-gjykatësin dhe ish-këshilltarin juridik të Presidentit të Republikës Shaqir Hasani, duke argumentuar : “Këshilli konstaton se kandidati Shaqir Hasani ka qenë këshilltar juridik i Presidentit të Republikës...ndaj ai nuk plotëson kushtin për lejimin e kandidimit...”⁶⁶.

E vërteta është se Hasani, ish-gjykatës me reputacion për ndershmërinë e tij, dallonte nga Metani sepse ai nuk ishte vëllai i ndonjë ministri socialist, nuk kishte qenë këshilltar i Edi Ramës, as edhe bashkëpunëtor i OSF. Ai ishte pasardhës i një familjeje me persekutim të thellë politik nga regjimi komunist.

Përveç këtyre, KED, për të nxjerrë të parin e listës prej 5 kandidatësh për ILD që i dërgoi parlamentit, i akordoi Metanit 86,8 pikë, ndërkohë që të dytit në listë, një prokurori që kishte kaluar edhe vetingun dhe që plotësonte të gjitha kushtet ligjore, i akordoi 86 pikë.

2.6 Kapja e sistemit të drejtësisë nëpërmjet procesit të vetingut të gjykatësve.

Opozita ka mbështetur me bindje të plotë si të domosdoshëm procesin e vetingut të gjykatësve dhe prokurorëve të vendit e jo vetëm të atyre, por edhe të politikanëve, gjë për të cilën ne dërguam një ligj të veçantë në parlament, miratimin e të cilit e refuzoi mazhoranca socialiste.

⁶⁵ Ligji Për Nëpunësin Civil, nr. 152/2013 (amenduar me anë të ligjit nr. 178/2014 dhe ligjit nr 41/2017), Ligji Per Organizimin Dhe Funksionimin E Keshillit Te Ministrave, nr. 9000, datë 30.1.2003.

⁶⁶ Dokumenta/ Përballja Artur Metani-Shaqir Hasanaj zbulon standardet skandaloze të KED, Boldnews, 21.08.2020, <https://boldnews.al/2020/08/21/dokumenta-perballja-artur-metani-shaqir-hasanaj-zbulon-standardet-skandaloze-te-ked/> shkarkuar më 19 korrik 2021.

Por opozita ka insistuar që vetingu të garantojë një proces të drejtë ligjor dhe ka denoncuar kapjen politike të procesit të vetingut nëpërmjet emërimit në grupin e komisionerëve të vetingut të ish-zëvendës ministrave e funksionarëve të qeverisë socialiste, të familjarëve të ministrave të Ramës, si P. Qirko-Balluku motra e ministres B. Balluku, të V. Sanxhaktarit ish-bashkëshortes së njërit prej banditëve kryesorë të bandës terroriste që vendosi autobombën në Tiranë në vitin 1996, apo emërimi si komisioner publik i F. Ballhysës shef kabineti i ish-ministrit dhe deputetit socialist, Fatmir Xhafa.

Në veçanti opozita ka kundërshtuar aplikimin e standarteve të dyfishta gjatë këtij procesi dhe përdorimin e qëllimshëm në realizimin e tij të metodës Top-Down në vend të asaj Bottom-Up.

Përdorimi i standarteve të dyfishta i dha mundësi qeverisë të përdorë procesin për gjueti shtrigash. Më sipër është përmendur rastin tipik Dvorani përkundrejt B. Muçi, por raste të tjera janë të shumta. Mbajtja sekret nga KLGJ e rezultateve të vetingut për anëtarët e emëruar rishtas të Gjykatës së Lartë, S.Sadushi, I.Panda dhe E.Pupe është gjithashtu një standart i dyfishtë dhe antikushtetues. Komisioni i Venecias, në raportin e tij të datës 19 qershor 2020 lidhur me vetingun, konstaton se disa kandidatëve komisioni i vetingut (KPK) u linte afat ligjor vetëm dy javor për paraqitjen e dokumenteve të kërkuara dhe në rast se nuk i paraqisnin largoheshin nga detyra, ndërsa në raste të tjera afati zgjatej, pa pasur një bazë ligjore për këtë⁶⁷.

Duke zbatuar standarte të dyfishta, qeveria përdori institucionet e saj, si autoritetet tatimore, policinë, Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Shërbimin Informativ Shtetëror (SHISH). Këto institucione, në bazë të ligjit, kanë detyrimin ligjor të paraqesin para organeve të vetingut të dhënat që ata disponojnë mbi individët që janë subjekt i vetingut, por të dhënat nuk i bëhen të ditura subjektit të vetingut. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Engjëll Agaçi, i cili kontrollonte të dhënat që këto agjenci kishin mbi subjektet e vetingut, luajti një rol kritik jo-ligjor në seleksionimin e të dhënave që u dorëzoheshin komisionerëve të organeve të vetingut për çdo subjekt nën proces vetingu. Për më tepër, në fillim të procesit të vetingut, kryeministri ndryshoi pa ndonjë motiv ligjor, kreun e DSIK dhe SHISH.

Përdorimi i metodës Top-Down në vend të asaj Bottom-Up ishte çështje madhore, që ndau qëndrimin e qeverisë nga ai i opozitës, e cila kundërshtoi përdorimin e metodës Top Down, sepse kjo e fundit është metodë që lejon ndërhyrjen nga sipër, në rastin konkret nga ekzekutivi. Sikundër u provua në Shqipëri, ajo është metodë destruktive, pasi në një rast të pashembullt në histori e la vendin për katër vjet pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë të Lartë. Pasojat e këtij vakumi ishin, përveç kriza e rëndë kushtetuese, dekapitimi i shtetit ligjor dhe miliarda euro dëme ekonomike nga bllokimi i

⁶⁷ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2020\)010-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)010-e), §82

rreth 36 000 dosjeve në Gjykatën e Lartë, e cila edhe sot ka vetëm 9 nga 19 gjykatës që duhet të ketë. Ky vakum mund të parandalohet plotësisht po të mos bllokohej për dy vjet me radhë nga qeveria funksionimi i KED dhe nëse në procesin e vetingut përdorej metoda Bottom Up për të cilën insistoi opozita. Përveç këtyre sot të gjitha gjykatat e apelit, sipas vetë kryetares së KLGJ, janë “në kolaps dhe nga 78 gjyqtarë që ushtrojnë detyrën vetëm 25 janë funksionalë dhe ky numër zvogëlohet për shkak të vetingut.”⁶⁸. Në kolaps edhe më të thellë janë gjithashtu edhe gjykatat e faktit, në të cilat në shumë raste nuk formohen dot trupat gjykuese me tre anëtarë.

2.7 Kapja e drejtësisë nga PS nëpërmjet Institutit East-West të Menaxhimit.

Si pasojë e vakumit të krijuar nga metoda Top-Down, stoku i dosjeve që pritet të shqyrtohen nga gjykatat sot ka arritur në 100000. Vetëm në Gjykatën e Lartë stoku i dosjeve është mbi 30000 dhe, sipas disa përllogaritjeve për shqyrtimin e dosjeve stok, do të duhen së paku dy dekada të tëra. Me pretekstin e përshpejtimit të gjykimit të dosjeve, kryetarja e KLGJ, N. Llagami në korrik të vitit 2021 firmosi në kundërshtim me Kushtetutën dhe kodet e vendit një marrëveshje për “menaxhimin” e këtyre dosjeve nga East West Management Institute (EWMI), një organizëm i financuar nga Fondacioni Soros, i cili në Shqipëri drejtohet nga Delina Fico, bashkëshorte e ministrit të brendshëm B. Çuçi, ish-gruaja e dytë e Edi Ramës, ish-presidente e OSFA. Detyra e EWMI, sipas marrëveshjes, është t’u përgatisë gjykatësve të Gjykatës së Lartë (GJL) dosjet për gjykim⁶⁹.

Dhënia me koncesion e menaxhimit të dosjeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë është një praktikë e kundërligjshme, pasi detyrën e përgatitjes së dosjeve e kryejnë këshilltarët ligjore të GJL, të cilët sipas kuadrit ligjor në fuqi, duhet të kenë një kualifikim të specifikuar sipas ligjit. Një pjesë e tyre, këshilltarët magjistratë, e fitojnë këtë funksion pas trajnimit të posaçëm dhe viteve të studimit me kohë të plotë pranë Shkollës së Magjistraturës, ku ata pranohen në bazë të konkurrimit, ndërsa këshilltarët ligjorë jo-magjistratë të GJL vijnë nga radhët e juristëve të cilët përmbushin kriteret sasiore dhe cilësore të përcaktuara në mënyrë rigorozë në ligj (ligji no.98/2016, neni 34). Pra ligji përcakton qartë se administrimi i dosjeve bëhet brenda sistemit gjyqësor, nga persona të cilët përmbushin kriteret ligjore për ushtrimin e funksioneve të tilla dhe që janë përzgjedhur nga institucionet përkatëse vetëm në bazë të kritereve të emërimit të tyre. Për

⁶⁸ “Gjykatat e Apelit në kolaps”/ Kryetarja e KLGJ ngre shqetësimin e mungesës së gjyqtarëve: Nuk ka kandidatura, po pengohet puna”, Panorama.al, 2 qershor 2021, <http://www.panorama.com.al/gjykatat-e-apelit-ne-kolaps-kryetarja-e-klgj-ngre-shqetesimin-e-mungeses-se-gjyqtareve-nuk-ka-kandidatura-po-pengohet-puna/> shkarkuar më 30 gusht 2021.

⁶⁹ Deklarata në faqen zyrtare në facebook të Këshillit të Lartë Gjyqësor <https://m.facebook.com/102768788451391/posts/199025678825701/?d=n> shkarkuar më 30 gusht 2021.

më tepër, siç është shpjeguar më lart, sipas nenit 179/b § 4 të Kushtetutës, të gjithë këshilltarët e Gjykatës së Lartë duhet t'i nënshtrohen veting-ut, sipas⁷⁰.

Për kontrast, ekspertët e EWMI që do të administrojnë stokun, janë në tërësi juristë që nuk kanë përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës, nuk kanë status në sistemin gjyqësor apo në shërbimin civil të vendit dhe nuk përmbushin kriteret e tjera të kërkuara nga ligji. Ata në shumicë janë anëtarë të Klubit të Juristëve (seksion i Organizatës të Rinjve të Partisë Socialiste FRESSHA), të cilët kanë përfunduar Akademinë Juridike të FRESSHA. Marrëveshja midis KLGJ dhe EWMI u arrit me pëlqimin dhe nxitjen e ambasadores së SHBA në Tiranë, Yuri Kim, gjë për të cilën ambasada bëri njoftim në faqen e saj në facebook⁷¹.

3. Rezultatet e reformës në drejtësi.

Pesë vjet pas votimit të paketës kushtetuese në parlament rezultatet paraprake më kryesore të reformës të sistemit të drejtësisë në Shqipëri janë:

1. Kapja e plotë e sistemit të drejtësisë. Sot të gjitha organet drejtuese pa përjashtim dhe edhe procesi i administrimit të dosjeve gjyqësore kontrollohen si kurrë më parë nga qeveria nëpërmjet njerëzve të besuar të saj.

2. Me vendosjen e drejtësisë nën kontrollin e qeverisë ish-komuniste në Shqipëri, OSF kontribuoi në zëvendësimin *de facto* të shtetit ligjor me partinë-shtet, e cila sipas një studimi krahasues kontrollon sot nëntëdhjetë përqind të pushteteve në Shqipëri, gati 10 përqind më shumë nga sa kontrollonte Partia e Punës e Shqipërisë në vitin 1991⁷².

3. Falimentimi i sistemit të drejtësisë që do t'u garantonte qytetarëve shqiptarë një proces të drejtë gjyqësor. Prej 5 vjetësh qytetarët shqiptarë për mungesë të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese nuk kanë pasur mundësi të kenë akses në gjykatat e sistemit gjyqësor shqiptar. Në mohimin *de facto* të kësaj të drejte themelore sigurisht ndikim të madh ka patur rënia dramatike e numrit të gjykatësve dhe prokurorëve në

⁷⁰ Dispozita kushtetuese në fjalë përcakton se: "4. Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish prokurorët, ish këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet."

⁷¹ Deklarata në faqen zyrtare të Ambasadës së SHBA në Shqipëri <https://www.facebook.com/usembassytirana/posts/10158403106035838> shkarkuar më 30 gusht 2021, dhe raportet në media [35.000 dosje të prapambetura në GJL/ Ambasada Amerikane: USAID dhe KLGJ nënshkruan memorandum për ndihmë teknike | MCN TV](#) shkarkuar më 30 gusht 2021.

⁷² Sipas një studimi të institutit të Studimeve Politike, mars 2020, <https://politiko.al/isp-ps-drejtton-90-te-te-gjithe-pushtetit-politik-ne-vend-me-shume-se-partia-e-punes-ne-91-shin> shkarkuar më 30 gusht 2021.

gjykatat e faktit dhe ato të apelit. Por përveç këtyre, me 100000 dosje stok në të gjitha nivelet e drejtësisë, shqyrtimi i tyre sipas ekspertëve kërkon dekada dhe mijëra e mijëra qytetarë të moshuar nuk do të marrin dot drejtësi për së gjalli.

4. Bllokimi i çështjeve civile të pronave, kontratave, investimeve në këto katër vjet në Gjykatën e Lartë i ka shkaktuar vendit mbi 5 miliard euro humbje dhe përveç kësaj, në këto pesë vjet në Shqipëri nuk ka ardhur asnjë investitor i huaj serioz, përkundrazi janë larguar disa të tillë.

5. Mungesa për rreth katër vjet e Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese për shkak të vetingut Top Down dhe bllokimi i ngritjes së tyre nga qeveria me qëllim kapjen e tyre, u bë një nga shkaqet më kryesore për mos hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE së paku për katër vjet me radhë.

6. Përfitues kryesorë të reformës në drejtësinë tashmë të kapur në Shqipëri janë qeveria, krimi i organizuar, kartelet e drogës dhe korrupsioni, të gjitha këto të fundit të lidhura me qeverinë. Sot mbi nëntëdhjetë përqind e të gjitha gjyqeve të qytetarëve dhe bizneseve private kundër qeverisë fitohen nga kjo e fundit. Edhe në ato pak raste kur nuk fitohen prej saj, vendimet e gjykatave nuk zbatohen ose anulohen me urdhër ekzekutiv. Kështu ndodhi, për shembull, edhe me vendimin Nr. 29, datë 02.07.2021, të Gjykatës Kushtetuese në të cilin anulohet vendimi i qeverisë për t'ia kaluar në pronësi truallin e tokës së Teatrit Kombëtar Bashkisë së Tiranës. Menjëherë pas këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese qeveria nxori vendim të ri me të cilin truallin e Teatrit Kombëtar ia kalonte përsëri Bashkisë së Tiranës⁷³. Përmendim për kontrast se deri në vitin 2013, 65-70 përqind e proceseve gjyqësore kundër qeverisë fitoheshin nga qytetarët dhe bizneset.

Sot në Shqipëri krimi i organizuar trafikantët e drogës dhe korrupsioni janë në revansh të papërmbajtur. Kapja e shtetit në Shqipëri është më e rënda në rajon⁷⁴. Krimi i organizuar dhe kartelet e drogës, të lidhura me qeverinë, sipas raporteve ndërkombëtare diktojnë miratimin e ligjeve në parlament dhe vendimeve në qeveri dhe përcaktojnë fituesit e tenderave dhe koncesioneve. Vitet e fundit parlamenti votoi tetë ligje për interesa specifike të bosëve të karteleve të drogës të lidhur me pushtetin⁷⁵.

⁷³ Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.495, datë 30.07.2021, "Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 1/241, të llojit truall, në zonen kadastrale nr.8150, Tiranë", publikuar në gazetën zyrtare nr.123, datë 04.08.2021. Shih gjithashtu [Kalimi i truallit të Teatrit tek Bashkia Tiranë shpërfill vendimin e Kushtetueses, akuzon opozita - Exit | Shpjegon Shqipërinë](#) , datë 31.07.2021, shkarkuar 30 gusht 2021.

⁷⁴ Raporti rajonal: Në Shqipëri shfaqet forma më e rëndë e kapjes së shtetit, grupet përdorin entet publike "për të luftuar" njëri-tjetrin, Revista Monitor, datë 9.05.2021, <https://www.monitor.al/raporti-rajonal-ne-shqiperi-shfaqet-forma-me-e-rende-e-kapjes-se-shtetit-grupet-perdorin-entet-publike-per-te-luftuar-njeri-tjetrin> shkarkuar më 22 gusht 2021.

⁷⁵ Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri: Një shqyrtim i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe ligjeve të bëra me porosi nga viti 2008 deri në 2020, raport nga Transparency international dhe instituti për Demokraci dhe

Shqipëria vlerësohet në raportet e DASH si qendër operationale e krimit të organizuar që vepron në rajon, Europë, Shtetet e Bashkuara, Lindjen e Mesme dhe Amerikën e Jugut⁷⁶ dhe është futur në listën e zezë të vendeve kryesore të pastrimit të parave⁷⁷.

Ekspertë analistë dhe media të huaja e konsiderojnë Shqipërinë si narkoshtetin e parë dhe të vetëm në Europë⁷⁸.

Korrupsioni shtrihet në të gjitha nivelet dhe vlerësohet si rampant dhe pervaziv. Çmimet e punëve publike me paratë e buxhetit të shtetit në Shqipëri kushtojnë 6-8 herë më shumë sesa punët publike të kryera në terrene të ngjashme me financimet e bankave europiane; prokurimet sekrete janë rritur me 15 herë krahasuar me vitin 2013. Këtë vit Shqipëria renditet e dyta në botë për nivelin e rryshfetit, sipas një studimi të Bankës Botërore⁷⁹. Dy vjet pas ngritjes së prokurorisë dhe Gjykatës së Posaçme (SPAK dhe GJKK), me gjithë rritjen me 300 përqind të korrupsionit, krahasuar me atë të para vitit 2013⁸⁰, jo vetëm që nuk është dënuar asnjë zyrtar i lartë për korrupsion, por nuk është hapur asnjë nga dosjet e aferave të mëdha të korrupsionit të Ramës dhe ministrave të tij, ku secila prej tyre arrin në qindra e qindra milionë euro. Ne vitin 2020 u derguan për gjykim nga SPAK për veprën penale të korrupsionit gjithsejtë 63 të pandehur. Për kontrast përmendim se sipas

Ndërmjetësim, 2021, ISBN: 978-3-96076-171-6,

https://images.transparencycdn.org/images/2021_Report_DeconstructingStateCaptureAlbania_Albanian.pdf (shkarkuar më 22 gusht 2021). Për një përmbledhje të tij shih Raporti për kapjen e shtetit/ 9 ligjet që u votuan për interesa okulte, Lapsi.al, datë 30.03.2021, <https://lapsi.al/2021/03/30/raporti-per-kapjen-e-shtetit-9-ligjet-qe-u-votuan-per-interesa-okulte/> (shkarkuar më 22 gusht 2021).

⁷⁶ Departamenti i Shtetit, SHBA, The 2019 international Narcotics Control Strategy Report submitted to the US Congress, vol.2, fq.37, <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2019/03/iNCSR-Vol-iNCSR-Vol.-2-pdf.pdf> shkarkuar më 23 gusht 2021.

⁷⁷ Albania on State Department money-laundering blacklist, The Economist, intelligence Unit, 21 Mars 2017, http://country.eiu.com/article.aspx?articleid=735240857&Country=Albania&topic=Economy&subtopic=Fo_7 shkarkuar më 23 gusht 2021.

⁷⁸ 'Colombia of Europe': How tiny Albania became the continent's drug trafficking headquarters, The independent, 27 janar 2019, <https://www.independent.co.uk/news/world/europe/albania-drug-cannabis-trafficking-hub-europe-adriatic-sea-a8747036.html> shkarkuar më 22 gusht 2021.

The inside Story of Europe's First Narco-State, [The inside Story of Europe's First Narco-State \(vice.com\)](https://www.vice.com/en/article/the-inside-story-of-europe-s-first-narco-state) 6 qershor 2019, shkarkuar më 25 gusht 2021.

The Proliferation of Organized Crime Groups in Europe's First "Narco-State": A Look at Albania in the post-Cold War Era, Diana Roy, The World Mind issue, 5.2,

<https://www.theworldmind.org/home/category/World+Mind+issue+5.2> shkarkuar më 22 gusht 2021.

'I Might Buy it All': Albania Fights Losing Battle against Money Laundering, BIRN, Klodiana Lala, 10 mars 2021, <https://balkaninsight.com/2021/03/10/i-might-buy-it-all-albania-fights-losing-battle-against-money-laundering/> shkarkuar më 22 gusht 2021.

⁷⁹ <https://www.enterprisesurveys.org/en/data/exploreconomies/2019/ai>

⁸⁰ ibid.

raportit të Departamentit të Shtetit, ne vitin 2009 njesia speciale e luftes kunder korrupsionit dergoj per gjykim 383 raste, nga të cilat gjykata dha 346 vendime fajsie. Përsëri për krahasim vëmë në dukje se, në vitet 2005-2007 prokuroria e krimeve të rënda dhe gjykata e këtyre krimeve në një hark kohor prej 18 muajsh akuzuan dhe dënuan me burgim mbi 1050 anëtarë dhe bosë të bandave e grupeve kriminale dhe qindra e qindra zyrtarë për veprën e korrupsionit, përfshi këtu edhe zyrtarë të lartë. Funksionimi i shtetit ligjor dhe i ekonomisë së tregut bënë të mundur anëtarësimin e Shqipërisë në Nato, firmosjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, liberalizimin e vizave me BE dhe rekomandimin nga Komisioni Europian për statusin e vendit kandidat në BE, përmirësimin e ndjeshëm të klimës së biznesit, dyfishimin e të ardhurave buxhetore dhe katërfishimin e investimeve të huaja. Shqipëria në një *quantum leap* të vërtetë, në vitin 2008 kaloi nga grupi i vendeve të varfëra në grupin e vendeve me të ardhura të mesme të larta. Në pesë vitet e fundit asnjë investitor serioz nuk ka sjellë investime në Shqipëri. Përkundrazi, disa prej tyre janë larguar nga vendi. Ndërkohë që në vitet 2005-2013 në Shqipëri zbarkuan Shell, konsorciumi Transadriatik Pipline TAP, San Paulo, OMNIX, Statkraft, Bechtel, Enka, Strabag, Actor etj.

7. Kohët e fundit, pas një seri akuzash të rënda⁸¹, të rrëzuara në fund të hetimeve në gjykatë, Adriatik Llalla, ish Prokurori i Përgjithshëm i Shqipërisë, u dënua me dy vjet burg për mosdeklarim të ardhurash. Ndërkohë, për vepra penale të njëjta ose më të rënda gjyqtarë dhe prokurorë të tjerë kaluan me sukses në procesin e vetting-ut dhe ruajtën pozicionet drejtuese në sistemin e drejtësisë. Më parë z.Llalla kish denoncuar publikisht se ambasadori amerikan Donald Lu i kishte kërkuar arrestimin e Kryetarit të Parlamentit në vitin 2015⁸². Ambasadori amerikan akuzoi Llallën se ishte kundërshtar i reformës në drejtësi sepse ai kishte deklaruar se "procesi i konsultimit të reformës mungonte"⁸³. Z.Llalla bëri publike kërkesën e ambasadorit Lu për mbylljen e hetimit të prokurorisë për kompaninë e naftës Bankers Petroleum, e cila filloi për shkak të dëmeve të konsiderueshme të shëndetit dhe shtëpive të banorëve të Marinzës, nga shpimet e

⁸¹ Hetimi filloi për katër akuza të rënda. Shih Exit.al, Former Prosecutor General Charged With Non-Declaration of Income, 20.11.2020, <https://exit.al/en/2020/11/20/former-prosecutor-general-charged-with-non-declaration-of-income/>, shkarkuar më 26 shtator 2021.

⁸² Llalla: Donald Lu më kërkoi arrestimin e Ilir Metës (Dokumentat e Kongresit Amerikan), Lapsi.al, datë 11.04.2018, <http://lapsi.al/2018/04/11/ekskluzive-llalla-donald-lu-me-kerkoi-arrestimin-e-ilir-metes-dokumentat-e-kongresit-amerikan/>, shkarkuar më 26 shtator 2021.

⁸³ Balkanweb, 11.02.2017, "Il Giornale": Përplasja e Llallës me ambasadorin Lu, pas kuintave fshihet Soros", <https://www.balkanweb.com/il-giornale-perplasja-mes-kryeprokurorit-llalla-dhe-ambasadorit-lu-pas-kuintave-fshihet-george-soros/?q=il-giornale-perplasja-mes-kryeprokurorit-llalla-dhe-ambasadorit-lu-pas-kuintave-fshihet-george-soros/> shkarkuar më 26 shtator 2021.

kompanisë për naftë⁸⁴. Zoti Llalla deklaroi se Sekretari i Shtetit i asaj kohe, Rex Tillerson, ishte aksioner i Bankers Petroleum⁸⁵. Sipas mediave, George Soros ishte gjithashtu aksioner i kësaj kompanie⁸⁶. Pas refuzimit të z.Llalla për mbylljen e hetimeve ndaj Bankers Petroleum, ambasadori Lu e kish kërcënuar se do të mbante përgjegjësi në rastet se nuk do të hiqte dorë nga akuzat penale ndaj kompanisë⁸⁷. Më 17 maj 2017, z.Llalla i dërgoi një letër Senatit të SHBA duke shpjeguar rolin e Fondacionit Soros në reformën në drejtësi në Shqipëri, si dhe ndërhyrjet jo diplomatike të ambasadorit Donald Lu⁸⁸. Kur letra u bë publike në vitin 2018, ambasadori akuzoi Llallën për korrupsion⁸⁹. Në të njëjtin vit Z. Llalla u caktua "non grata" për korrupsion nga Sekretari i Shtetit Rex Tillerson⁹⁰.

Pikërisht të gjitha këto kanë bërë që sot, 5 vjet pas fillimit të reformës, studime dhe raporte serioze të njoftojnë për rënie të madhe të besimit të qytetarëve te reforma dhe sistemi i drejtësisë. Mbi 63% e qytetarëve nuk i besojnë procesit të vetingut, vetëm 32% mendojnë se reforma është zbatuar siç duhet dhe shumica e qytetarëve besojnë se korrupsioni në sistemin e drejtësisë këto dy vitet e fundit është rritur ndjeshëm⁹¹.

⁸⁴ TV Klan, Opinion TV show, datë 3.2.2017, <https://tvklan.al/opinion-shperthimi-i-prokurorit-te-pergjithshem/>, min.33.30 et seq, shkarkuar më 26 shtator 2021.

⁸⁵ Intervistë e z.Adriatik Llalla në Syri TV, 31.05.2021,

<https://www.syri.net/politike/426738/intervista-e-plote-ish-kryeprokurori-adriatik-llalla-ne-cim-peka-live/> shkarkuar më 26 shtator 2021.

⁸⁶ Soros Buys 20% of BNK Petroleum, 19.10.2010, <https://www.gurufocus.com/news/109858/soros-buys-20-of-bnk-petroleum> shkarkuar më 26 shtator 2021. Shih gjithashtu, Gazeta Telegraf, 28.12.2016, Lëndët kimike të Bankers, burim sëmundjesh kancerogjene, shkarkuar më 26 shtator 2021 <https://telegraf.al/politike/lendet-kimike-te-bankers-burim-semundjesh-kancerogjene/>

⁸⁷ Exit.al, datë 21.04.2018, Obstruction of Justice, US Ambassador Donald Lu Pressed General Prosecutor Llalla To Drop Bankers Petroleum Investigation, <https://exit.al/en/2018/04/21/obstruction-of-justice-us-ambassador-donald-lu-pressed-general-prosecutor-llalla-to-drop-bankers-petroleum-investigation/> shkarkuar më 26 shtator 2021.

⁸⁸ Exit.al, 12.04.2018 US Ambassador Lu Denies Request to Arrest Ilir Meta, Attacks Llalla, <https://exit.al/en/2018/04/12/us-ambassador-lu-denies-request-to-arrest-ilir-meta-attacks-llalla/> shkarkuar më 26 shtator 2021

⁸⁹ Ibid.

⁹⁰ US Department of State, 14.02.2018, Media Note, Public Designation of Adriatik Llalla under Section 7031(c) of the FY 2017 Consolidated Appropriations Act, <https://2017-2021.state.gov/public-designation-of-adriatik-llalla-under-section-7031c-of-the-fy-2017-consolidated-appropriations-act/index.html> , shkarkuar më 26 shtator 2021.

⁹¹ [Sondazhi/ 63% nuk besojnë te Vettingu. Ç'lojë po luan Soros? – Lapsi.al](#) publikuar më 08 prill 2019, shkarkuar më 22 gusht 2021. [Për të tretin vit rradhazi, ulet besimi te Reforma në Drejtësi - Exit | Shpjegon Shqipërinë](#) datë 13 maj 2020, citon një tjetër sondazh të institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim në lidhje me Besimin në Qeverisje 2019, publikuar në 2020, [Public Opinion Poll: Trust in Governance 2019 - \(idmalbania.org\)](#) , Zëri i Amerikës, datë 22

4. Konkluzion

Reforma e sistemit të drejtësisë në Shqipëri u konceptua e u formulua nga OSF në planin e strategjisë të këtij fondacioni për vitet 2014-2017 të publikuar në dhjetor të vitit 2013. OSF me ndihmën e tij financiare dhe teknike do të ishte jo vetëm ideatori, por edhe iniciatori, sponsori dhe promotori kryesor i kësaj reforme.

Në krye të radhës OSF organizoi tryezat e gjera të debateve me përfaqësues të shoqërisë civile, universiteteve, forcave politike dhe grupeve të interesit për aspektet themelore të reformës. OSF mori përsipër zhvillimin e sondazheve të opinioneve rezultatet e të cilave dallonin shumë me sondazhe të tjera serioze ndërkombëtare.

OSF, me qeverinë, krijoi me bashkëpunëtorët e këtij fondacioni trurin e reformës - Grupin e Ekspertëve të Lartë të Reformës (GELR) - anëtarët e të cilit u paguan direkt prej tij deri në fund të reformës. Misioni i GELR ishte hartimi i amendamenteve kushtetuese dhe ligjeve organike të reformës në drejtësi. Pas fillimit të punës doli e qartë se GELR paraqiti një model të sistemit të drejtësisë *sui generis*, që nuk ekziston në asnjë vend të botës e se ai dhe mazhoranca kishin si qëllim kryesor të reformës vendosjen e sistemit të drejtësisë nën kontrollin e qeverisë së Edi Ramës, mikut të George Soros.

Komisioni i Venecias rrëzoi njërin pas tjetrit, në dhjetor të vitit 2015 dhe në mars të vitit 2016, dy draftet e ndryshimeve kushtetuese të përgatitura nga GELR dhe të miratuara vetëm me votat e mazhorancës në Komisionin e Posaçëm Parlamentar të Reformës (KPPR), duke arsyetuar se ato e vendosnin sistemin e drejtësisë nën kontrollin e ekzekutivit.

Opozita, ndonëse pa të drejtë vetoje dhe anipse ekspertët e saj nuk u pranuan nga GELR, mori pjesë në KPPR

Pas dështimit të dy drafteve të GELR në Komisionin e Venecias, me insistimin e saj dhe ndërmjetësimin e zyrtarëve të lartë ndërkombëtarë, u dakordësua për një formulim të paketës së ndryshimeve kushtetuese që ishte në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias. Ndryshimet kushtetuese u miratuan me unanimitet nga parlamenti, në 21 korrik të vitit 2016.

Por pas kësaj qeveria dhe GELR rikthyen në ligjet organike të reformës të gjithë mekanizmat e kapjes së sistemit të drejtësisë dhe, duke shkelur konsensusin, i kaloi këto ligje për miratim vetëm me votat e mazhorancës. Bazuar në këto ndryshime dhe në

mars 2021 (<https://www.zeriamerikes.com/a/5824060.html>) citon Barometrën e Sigurisë Shqipëri për 2020, studim në rang kombëtar i kryer nga CSDG dhe fondacioni Friedrich Ebert Stiftung, http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2021/03/barometri_i_sigurise_2020_SHQIP-WEB.pdf, shkarkuar më 22 gusht 2021.

zbatim të tyre, mazhoranca dhe GELR vendosën drejtësinë në kontroll të plotë të qeverisë socialiste, duke emëruar në krye të organeve drejtuese të sistemit të drejtësisë, në kundërshtim të hapur me kriteret kushtetuese dhe ligjore, ish-ministra, zëvendës ministra, vëllezër, kunetër të ministrave të PS, ish-gjykatës, prokurorë të proceseve politike dhe bashkëpunëtorë të policisë sekrete të Enver Hoxhës, në tërësi bashkëpunëtorë ose ish-punonjës të OSF.

Krahas këtyre emërimeve, qeveria duke përdorur vetingun si gjah shtrigash, por edhe si instrument pengmarrjeje, largoi nga detyra, duke aplikuar standarte të dyfishta, të gjithë gjykatësit dhe prokurorët që ajo i konsideronte kundërshtarë të saj, nisur nga çështjet që ata kishin gjykuar në lidhje me zyrtarët e qeverisë apo bosët e krimit të lidhur me qeverinë.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave mori një rol kryesor ekstraligjor në procesin e vetingut. Ai kontrollonte informacionin që dispononin agjencitë e varura nga qeveria, si autoriteti tatimor, policia e shtetit, Agjencia e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi Informativ Kombëtar, të cilat sipas ligjit duhej t'i dorëzoheshin KPK për personat që i nënshtroheshin procesit të vetingut.

Si rezultat i metodës destruktive Top Down, që qeveria aplikoi në procesin e vetingut, por edhe përpjekjeve të hapura të saj për të kapur me çdo kusht Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, vendi mbeti 4 vjet pa gjykatë të lartë dhe pa gjykatë kushtetuese, gjykatat e apelit mbetën me 1/4 e gjykatësve e po kështu edhe ato të faktit.

Prej 5 vjetësh qytetarët shqiptarë kanë humbur të drejtën e një procesi gjyqësor të drejtë. Stoku i dosjeve të pashqyrtuara ka tejkaluar në 100000.

Colpo di gracia në kapjen e gjyqësorit dhe në kundërshtim me çdo ligj të vendit, ishte dhënia me koncesion e menaxhimit të dosjeve të Gjykatës së Lartë një organizate të majtë private – East West Management Institute (EWMI) - të menaxhuar nga Delina Fico, bashkëshortja e ministrit të brendshëm dhe ish-bashkëshortja e Edi Ramës, si dhe ish-presidente e OSFA. Punonjësit e EWMI janë të përzgjedhur nga klubi i juristëve i organizatës së rinisë të Partisë Socialiste dhe nuk përmbushin standartet ligjore specifike për të shërbyer si këshilltarë të Gjykatës së Lartë dhe nuk kanë kaluar veting-un siç e kërkon Kushtetuta (neni 179/b). Kështu qeveria futi në duart e veta edhe përgatitjen e dosjeve mbi të cilat do të vendosin gjykatësit e Gjykatës së Lartë.

Opozita kundërshtoi dhe denoncoi çdo hap të bërë nga qeveria për kapjen e sistemit të drejtësisë. Kundërshtitë e saj jo vetëm nuk u përfillën, por kundër saj u ndërmor nga OSF dhe qeveria socialiste një fushatë propagandistike që synonte t'i paraqiste qëndrimet e drejta të saj si antireformë.

Si përfundim, reforma e drejtësisë në Shqipëri me ideator, iniciues dhe promotor kryesor OSF, shkatërroi sistemin fraxhil ekzistues të drejtësisë dhe e zëvendësoi atë me një sistem drejtësie *sui generis* dhe pa shtyllë vertebrore, totalisht të kapur nga qeveria socialiste, me të cilin mbi 90% të proceseve gjyqësore i fiton qeveria, bandat dhe kartelet e drogës të lidhura me të. Ajo privon qytetarët shqiptarë për vite e dekada në vijim nga e drejta e një procesi të drejtë ligjor.

OSF me veprimtarinë e vet partizane i ka bërë një dëm të pallogaritshëm demokracisë së brishtë në Shqipëri. Kjo së pari, me vendosjen e rrjetit të OJQ nën ombrellën e Partisë Socialiste, skemë me të cilën OSF riktheu modelin monist të tyre në Shqipëri dhe sot ato nuk janë më zëra të pavarur të shoqërisë, por organizata të manipuluar nga kjo parti. Së dyti, me vendosjen e drejtësisë nën kontrollin e qeverisë ish-komuniste në Shqipëri OSF kontribuoi *de facto* në zëvendësimin e shtetit ligjor me shtetin partiak apo partinë shtet, e cila kontrollon sot 90% të pushteteve në Shqipëri.

Për të gjitha këto do të ishte mëse e nevojshme që Kongresi i SHBA, Parlamenti Europian dhe Asambleja Parlamentare të Këshillit të Europës të hetojnë dhe të ndalojnë me ligj ndërhyrjet politike partizane të multimiliarderit George Soros jashtë territorit të SHBA, ose së paku në vendet ish-komuniste.

Së fundi, vlen të theksohet se 5 vjet pas votimit në parlament të ligjeve të reformës, nga 830 gjykatës dhe prokurorë që duhet t'i nënshtrohen vetingut, e kanë përfunduar këtë proces vetëm 420, nga të cilët 200 janë larguar prej sistemit nëpërmjet këtij procesi. Ndaj, vlerësohet se është urgjente zbatimi i rekomandimit të Komisionit të Venecias për shpejtimin ose edhe amendimin e procesit të vetingut. Sikundër është e dukshme nevoja e ndërhyrjeve të tjera ligjore, me ndihmën e Komisionit të Venecias, për të adresuar mbi një procedurë ligjore problemin e stokut të jashtëzakonshëm prej 100000 dosjesh dhe për të nxjerrë sistemin e drejtësisë jashtë kontrollit qeveritar, që janë jetike për shtetin ligjor dhe funksionimin e tij në Shqipëri.